



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 339 Akti

Nr. 473 Vendimi

Tiranë, më 5.11.2021

### V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Brunilda Bekteshi</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Pamela Qirko</b>	<b>Relatore</b>
<b>Roland Ilia</b>	<b>Anëtar</b>

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani dhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 3.11.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore në lidhje me çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Saemira Hila**, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, E, Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH-së”;

**Ligji 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

### TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Pamela Qirko, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

## I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në nenin 179/b, paragrafi 5 të ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe, në nenin 3, pika 5 dhe nenin 5, pika 1 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Saemira Hila, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) më 12.11.2019 zhvilloi procedurat e shortit të shpërndarjes së çështjeve në trupa gjykues, nga ku rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues, i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Pamela Qirko dhe Brunilda Bekteshi. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionere, znj. Pamela Qirko.
4. Në mbledhjen e parë të trupit gjykues të datës 19.11.2019, u caktua me mirëkuptim kryesues komisionerja Brunilda Bekteshi, si dhe u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues. Anëtarja Alma Faskaj paraqiti dorëheqjen nga shqyrtimi i kësaj çështjeje<sup>1</sup>. Trupi gjykues i ngritur për këtë qëllim, pas shqyrtimit të kërkesës për dorëheqje, vendosi pranimin e saj. Në vijim, anëtari zëvendësues i shortit të datës 12.11.2019, z. Roland Ilia, deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit. Trupi gjykues vendosi fillimin e hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për znj. Saemira Hila, e cila, gjithashtu, deklaroi<sup>2</sup> mospasjen e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.
5. Referuar pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për znj. Saemira Hila nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.
6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë” të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës” të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.
8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale” të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të

<sup>1</sup> Me kërkesën e datës 19.11.2019.

<sup>2</sup> Nëpërmjet komunikimit elektronik të datës 6.5.2020.

rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

**9.** Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ).

**10. Inspektorati i Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI)** ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Saemira Hila, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera në kuadër të kontrollit të pasurive/interesave privatë të subjektit të rivlerësimit, është konstatuar se:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;
- ka mosdeklarim të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë; dhe
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave

**11. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)** ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin e mbajtur për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

**12. Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ)** ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe në përfundim ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

**13.** Në vijim janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga pika 5 e nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

**14.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vlerësoi se arrijnë nivelin e provueshmërisë dhe, në datën 5.10.2021, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht, duke u bazuar vetëm në kriterin e pasurisë për subjektin e rivlerësimit, znj. Saemira Hila; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t’u njohur me materialet e dosjes në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40, 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) kalimin e barrës së provës për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**15.** Në vijim, po në datën 5.10.2021, subjektit i rivlerësimit u njoftua nëpërmjet adresës elektronike me anë të së cilës është kryer komunikimi gjatë procesit të rivlerësimit, në lidhje me rezultatet e hetimit administrativ, analizën financiare të kryer nga Komisioni dhe metodologjinë e përgatitjes së saj, në lidhje me të drejtën për të paraqitur

pretendime/shpjegime, të drejtën për të paraqitur prova të reja apo thirrjen e dëshmitarëve, në kuadër të së drejtës për t'u mbrojtur, duke i dhënë kohë brenda një afati të arsyeshëm prej 15 ditësh për të marrë akses në dosjen e rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit u njoh me të gjitha aktet e dosjes më 11.10.2021, duke disponuar kopjen e saj në format elektronik (CD).

**16.** Në datën 18.10.2021, subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet adresës elektronike, kërkoi shtyrje të afatit, për të paraqitur mbrojtjen, me arsyetimin se ishte në pritje për të siguruar disa dokumente për të provuar të kundërtën e barrës së provës, duke bashkëlidhur kërkesat e bëra për këtë qëllim<sup>3</sup>. Pas shqyrtimit të kërkesës së subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vendosi<sup>4</sup> shtyrjen e afatit deri në datën 1.11.2021, për të paraqitur dokumentacionin e kërkuar.

**17.** Në datën 1.11.2021, subjekti paraqiti në formë elektronike shpjegimet e saj, kërkoi administrimin e provave të reja në mbështetje të shpjegimeve dhe çeljen e hetimit gjyqësor edhe për dy kriteret e tjera, kontrollit të figurës dhe atij profesional.

**18.** Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit të rivlerësimit, në datën 1.11.2021, vendosi<sup>5</sup> pranimin e pjesëshëm të saj, duke disponuar mbi pranimin e administrimit të provave të reja dhe refuzimin e çeljes së hetimit edhe për dy kriteret e tjera, për sa provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë kishin arritur nivelin e provueshmërisë, bazuar në nenin 4 pika 2 dhe nenin 52 të ligjit nr. 84/2016. Në vijim, subjekti u njoftua nëpërmjet postës elektronike të datës 1.11.2021.

**19.** Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti, trupi gjykues, vendosi të ftojë<sup>6</sup> znj. Saemira Hila në seancë dëgjimore në datën 3.11.2021, ora 10.00.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

**20.** Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 3.11.2021, ora 10:00 në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati Kongreseve), salla B, kati 0, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi.

**20.1.** Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht dhe mori të gjithë kohën e duhur për të parashtruar shpjegimet në lidhje me procesin e rivlerësimit dhe rezultatet e hetimit administrativ, për sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë. Në përfundim të shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit depozitoi prova shkruesore, si dhe kërkesë<sup>7</sup> për thirrjen në cilësinë e dëshmitarëve të disa shtetasve, në vijim të së cilës, pas shqyrtimit, trupi gjykues me vendimin e datës 4.11.2021<sup>8</sup> vendosi refuzimin e kërkesës, bazuar në nenin 49, pikat 8, 9 dhe 6 germa “b” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016.

## **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**21.** Znj. Saemira Hila ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke shprehur gatishmëri për t'u përgjigjur në kohë pyetësorëve/kërkesave gjatë procedurës së hetimit administrativ, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

---

<sup>3</sup> Kërkesë për informacion datë 18.10.2021 drejtuar Ambasadës Italiane në Shqipëri nga z. A.Dh, dokument në gjuhën italiane për rezervim takimi në zyrën e njësisë territoriale në V, Itali për në datën 27.10.2021 për tërheqje certifikate.

<sup>4</sup> Me vendimin e ndërmjetëm nr. 3, datë 20.10.2021.

<sup>5</sup> Me vendimin e ndërmjetëm nr. 4, datë 1.11.2021.

<sup>6</sup> Subjekti u njoftua nëpërmjet adresës elektronike të datës 1.11.2021.

<sup>7</sup> Kërkesa u paraqit si pjesë integrale e aktit listë e provave të depozituara në seancë nga subjekti në datën 3.11.2021

<sup>8</sup> Me vendimin e ndërmjetëm nr. 5, datë 4.11.2021.

#### **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

**22.** Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

**22.1.** Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

**22.2.** Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

**22.3.** Por, referuar vendimit nr. 2/2017<sup>9</sup> të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

**22.4.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “Vetting”, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja; (ë) denoncimet e publikut; dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

---

<sup>9</sup> “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i papazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

## A. VLERËSIMI I PASURISË

**23.** Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe të ligjshmërisë së burimit dhe të krijimit të saj.

**23.1.** Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”, të paraqitur më parë në ILDKPKI, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Saemira Hila.

**23.2.** Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si edhe verifikimin e ligjshmërisë së të ardhurave të deklaruara si burim krijimi të pasurive. Në deklaratën “Vetting”, të dorëzuar në ILDKPKI më 27.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, si person i lidhur me të, kanë deklaruar respektivisht pasuritë (e luajtshme dhe të paluajtshme)/interesat privatë:

**24. Apartament,** në bashkëpronësi me bashkëshortin, me sipërfaqe totale 112.1 m<sup>2</sup>, me numër pasurie \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, S, Tiranë, blerë në datën 15.2.2011, me kontratë noteriale para noteres M. D, nga shitësi “\*\*\*\*” sh.p.k. Vlera e apartamentit 82.500 euro. Subjekti ka deklaruar se zotëron 50% pjesë takuese mbi këtë pasuri.

**24.1. Si burim krijimi** të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar: i) kredi bankare dhe hipotekë e datës 18.2.2011 në “Raiffeisen Bank”; shuma 5.000.000 lekë; ii) të ardhurat e fituara nga shitja e apartamentit të trashëguar nga prindërit, privatizuar me ligjin nr. 7652/1991; iii) të ardhurat e kursyera nga puna e secilit bashkëshort në vitet paraardhëse. Subjekti ka bashkëlidhur dokumentacion për të provuar burimet e krijimit që kanë shërbyer për blerjen e këtij apartamenti.

### Deklarimi i kësaj pasurie ndër vite

**25.** Në deklaratën e interesave privatë periodikë (në vijim referuar si “DIPP”) të vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar<sup>10</sup>: *“Me kontratën paraprahe të shitjes (kreditimi) dt 17.12.2010 unë dhe bashkëshorti si blerës dhe shoqëria \*\*\* Shpk si shitëse, kemi shprehur vullnetin për blerjen e një apartamenti të ndodhur në ZK \*\*\* S, Tiranë, çmimi i shitjes është 82,500 euro, nga të cilat 25,000 euro i kemi paguar shitësit. Diferenca prej 57,500 euro do të paguhej në momentin e lëvrimit të një kredie bankare në Raiffeisen Bank, dega Lushnjë..... E gjithë depozita jonë bankare e deklaruar më parë ka shkuar për llogari të blerjes së apartamentit”. Gjithashtu, në seksionin e ndryshimit të interesave privatë ka deklaruar: “Depozita bankare (USD) në Raiffeisen Bank, dega Lushnjë është tërhequr për tu përdorur e gjitha për blerjen e një apartamenti të ndodhur në zonën kadastrale \*\*\*, nr pasurie \*\*\*”.*

**25.1.** Në vijim, në DIPP 2011<sup>11</sup>, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: 1. *“Bashkëpronar me bashkëshortin, mbi një apartament me sip afërsisht 112m2, të ndodhur në Zonën Kadastrale \*\*\*, nr pasurie \*\*\*, F, Tiranë që nga janari 2011. Regj në ZVRPP Tiranë. 50% pjesë takuese”*

<sup>10</sup> Në seksionin e të dhënave konfidenciale.

<sup>11</sup> Në seksionin e ndryshimit të interesave privatë.

2. “kredi hipotekore e përdorur për blerjen e apartamentit si më sipër me afat 15 vjeçar nr \*\*\*, disbursuar në datën 09.03.2011 shuma 50,000,000 lekë<sup>12</sup>”.

3. Depozita bankare (USD) në Raiffeisen Bank, dega Lushnjë është tërhequr dhe përdorur e gjitha për blerjen e një apartamenti të ndodhur në zonën kadastrale \*\*\*, nr pasurie \*\*\*, F, Tiranë

### **Hetimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri**

**26.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ASHK-së, Drejtoria Vendore Tirana Rurale 1, rezulton regjistrimi i pasurisë në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur dhe, krahasuar me dokumentacionin e administruar në dosjen e ILDKPK-së për këtë pasuri, kanë rezultuar këto fakte:

**26.1.** Në datën 17.12.2010 është lidhur kontrata paraprake e shitjes<sup>13</sup> midis shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në cilësinë e palës shitëse dhe subjektit të rivlerësimit e bashkëshortit të saj, në cilësinë e palës blerëse, me objekt kalimin e pronësisë mbi një apartament me sipërfaqe ndërtimi në total 112,1 m<sup>2</sup>, i përbërë nga 97,9 m<sup>2</sup>, sipërfaqe apartamenti dhe 14,2 m<sup>2</sup>, sipërfaqe e përbashkët, me pagimin e kështit të fundit, kundrejt çmimit 82,500 euro.

**26.2.** Çmimi i përcaktuar në kontratë do të shlyhej me këste si vijon: kësti i parë në vlerën prej 25,000 euro është likuiduar nga blerësi jashtë zyrës noteriale, ndërsa kësti i dytë në vlerën prej 57,500 euro do të paguhej me anë të një kredie bankare që pala blerëse do të merrte në “Raiffeisen Bank”. Me likuidimin e vlerës së apartamentit, shitësi zhvishet nga pronësia e pasurisë, duke ia kaluar këtë të drejtë blerësit.

**26.3.** Në datën 15.02.2011, është lidhur kontrata e shitjes<sup>14</sup> midis palëve, në të cilin është përcaktuar se çmimi është likuiduar nga blerësit jashtë zyrës noteriale.

**26.4.** Më tej, po në datën 15.02.2011, është lidhur midis palëve kontrata e huas<sup>15</sup>, në të cilën është përcaktuar se subjekti i rivlerësimit ka detyrimin për të paguar shumën prej 37,500 euro, si vlerë e mbetur ende e papaguar për apartamentin objekt vlerësimi.

**26.5.** Në datën 18.02.2011 është lidhur kontrata e “kredisë bankare dhe hipoteke”<sup>16</sup> midis “Raiffeisen Bank” në cilësinë e palës kredihënëse/përfituesit, si dhe subjektit, personit të lidhur në cilësinë e palës kredimarrëse/hipotekuesit me objekt kreditimin në shumën 5,023,807 lekë për blerje shtëpie, me kushtin që pas pagimit të primit të sigurimit shoqërisë së sigurimit, vlera e kredituar do t’i kalohet shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., sipas kontratës paraprake të shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol, datë 17.12.2010. Për të siguruar përmbushjen e detyrimit sipas kësaj kontrate, është vendosur hipotekë pasuria objekt vlerësimi, e cila figuron e regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme në favor të “Raiffeisen Bank”.

**26.6.** Në zbatim të kontratës së kredisë është disbursuar shuma e kredisë 5,023,807 lekë në llogarinë e subjektit të rivlerësimit, në datën 9.3.2011.

---

<sup>12</sup> Rezulton se subjekti e ka deklaruar gabimisht shumën e kredisë pasi, referuar dokumentacionit banker, shuma e kredisë është 5,000,000 lekë.

<sup>13</sup> Kontrata paraprake shitjeje (kreditimi) nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol e datës 17.12.2010, redaktuar nga noteri publik M.D në dosjen e ILDKPKI-së, aneksi \*\*\*.

<sup>14</sup> Kontratë shitjeje me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 15.2.2011, aneksi \*\*\* dosja e ILDKPKI-së.

<sup>15</sup> Kontratë huaje me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 15.2.2011, në pyetësorin nr. 2.

<sup>16</sup> Kontratë kredie bankare me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.2.2011, në shkresën kthim përgjigjeje të “Raiffeisen Bank” me nr. \*\*\*, datë 12.3.2020.

**26.7.** Në datën 10.03.2011, ka rezultuar se nga llogaria e subjektit të rivlerësimit transferohet në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., vlera 5,000,000 lekë, me përshkrimin “*Likujdim për blerje apartamenti*”.

### **Burimet e krijimit**

**27.** Në analizën e burimeve të krijimit për pasurinë objekt vlerësimi, trupi gjykues u është referuar deklaratës të subjektit në “Vetting”, si dhe e ka krahasuar atë me deklaratën vjetor të vitit të krijimit të pasurisë.

### **Burimi 1: të ardhura të kursyera nga puna e secilit bashkëshort në vitet parardhëse**

**27.1.** Për verifikimin e këtij burimi krijimi, Komisioni u është referuar deklaratave vjetore të subjektit të rivlerësimit, ku evidentohen të deklaruara që në deklaratën e parë për vitin 2003 të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit si gjyqtare, si dhe të ardhurat për vitin 2004 nga personi i lidhur, nga ushtrimi i aktivitetit si stomatolog.

**27.2.** Nga hetimi i kryer për aktivitetin e bashkëshortit rezulton se shtetasi A.Dh është regjistruar si person fizik<sup>17</sup> me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë nr. \*\*\*, datë 31.3.2003, për ushtrimin e aktivitetit si dentist, si dhe pranë organit tatimor.

**27.3.** Të ardhurat nga ushtrimi i aktivitetit dentar, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, janë krahasuar me të dhënat zyrtare të marra nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier<sup>18</sup> dhe Bashkia Lushnjë<sup>19</sup>, me qëllim llogaritjen e qarkullimit vjetor dhe të ardhurat neto, të përfituara nga personi i lidhur. Këto të ardhura janë marrë në shqyrtim nga Komisioni, në kuptim të burimeve të krijimit për pasurinë objekt vlerësimi.

### **Në lidhje me depozitën në vlerën 67,000 USD**

**27.4.** Nga analizimi i deklaratave të subjektit në koherencë me njëra-tjetrën, duke filluar që nga DIPP 2004 e deri në vitin 2010, në të cilat subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pagimin e kështit të parë të çmimit të blerjes së apartamentit prej 25,000 eurosh, rezulton se subjekti ka disponuar depozitë bankare me burim krijimi kryesisht të ardhurat nga punësimi të bashkëshortit të saj.

**27.5.** Bazuar në deklaratimet periodike të subjektit, Komisioni ka kryer hetim në lidhje me krijimin dhe ndryshimin e kësaj depozite bankare, ndër vite, si dhe burimeve për krijimin e saj.

**27.6.** Nga hetimi bankar<sup>20</sup> konstatohet se depozita është krijuar në vitin 2004 në emër të bashkëshortit dhe subjektit të rivlerësimit dhe është shtuar ndër vite, bashkë me interesat bankare të akumuluar deri në datën 31.12.2009, në shumën 7,947,972 lekë. Në datën 8.3.2010, kjo shumë është konvertuar në valutën dollarë (USD), në vlerën 73,482 USD, e cila rezulton të jetë tërhequr përgjatë vitit 2010.

### **Krijimi i depozitës – viti 2004**

**28.** Në DIPP/2004 subjekti ka deklaruar për herë të parë pasurinë “depozitë”, krijuar në datën 8.9.2004, në pjesë takuese 50% bashkë me bashkëshortin: “*depozita bankare me afat në Raiffeisen Bank, trashëguar nga nëna ime M.H me vendim gjykate nr \*\*\* dt 08.09.2004 të Gjykatës Lushnje. Në dy numra llogarie bashkë me bashkëshortin tim A dhe të ardhurat e punës*”

<sup>17</sup> Shih korrespondencën e mbajtur me QKB-në me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.3.2020 dhe kthim përgjigjen nr. \*\*\* prot., datë 23.3.2020.

<sup>18</sup> Shkresa kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 20.5.2020, e DRT-së FIER.

<sup>19</sup> Shkresa nr. \*\*\*, datë 27.7.2017 nga Bashkia Lushnjë; shkresa nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2017 dhe nr. \*\*\* prot., datë 2.10.2016, administruar nga dosja e ILDKPKI-së.

<sup>20</sup> Shkresë kthim përgjigjeje “Raiffeisen Bank” me nr. \*\*\*, datë 12.3.2020.



së bashkëshortit. (i) Depozita në shumën **1,066,362 lekë**; (ii) Depozita në shumën **800,485 lekë**; (iii) Depozita në shumën **200,000 lekë**. Data e krijimit të pasurisë 08.09.2004.

**28.1** Më tej, nga hetimi bankar ka rezultuar se përgjatë vitit 2004 janë kredituar në llogarinë e depozitës nga bashkëshorti i subjektit shuma të ndryshme, të cilat, në total arrijnë vlerën 2,066,847 lekë, pra, sa shuma totale e depozitave të deklaruara në DIPP/2004 nga subjekti i rivlerësimit.

### **Hetimi i Komisionit në lidhje me burimet e krijimit të depozitës në vitin 2004**

#### **i) Burimi i parë - trashëgimia e nënës së subjektit, znj. M.H**

**29.** Me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë nr. \*\*\*, datë 8.9.2004, është vendosur lëshimi i dëshmisë të trashëgimisë ligjore për të ndjerën znj. M.H, në favor të trashëgimtarëve ligjorë, sipas të cilës subjekti i rivlerësimit dhe babai i saj kanë trashëguar përkatësisht secili nga ½ pjesë të pasurisë trashëgimore.

**29.1.** Nga hetimi bankar rezultoi se në datën 1.10.2004, në llogarinë e nënës së subjektit ka pasur një gjendje prej 1,000,000 lekësh, të cilat ishin depozitë e mbartur nga ish-Banka e Kursimeve. Pas maturimit të depozitës dhe kreditimit të interesit në datën 19.12.2004 gjendja e llogarisë ka qenë 1,066,362 lekë. Në vijim, në datën 29.12.2004 kjo shumë është tërhequr me përshkrimin “Vendim gjyqi nr \*\*\* datë 08.09.2004 prok \*\*\*, 08.10.2004” dhe brenda të njëjtës ditë konfirmohet se kjo shumë është depozituar *cash* nga personi i lidhur në llogarinë e përbashkët të subjektit dhe personit të lidhur, në të njëjtën bankë.

**29.2.** Nga analizimi i dëshmisë së trashëgimisë, konstatohet se trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë kanë qenë subjekti dhe babai i saj, me nga ½ pjesë takuese mbi pasurinë trashëgimore. Nga administrimi i dokumentacionit në dosjen e hetimit nuk rezultoi që i ati, z. J.H, të kishte hequr dorë nga trashëgimia, sipas nenit 333 të Kodit Civil, ndërkohë, rezulton se subjekti i rivlerësimit e gëzonte e vetme depozitën e trashëguar nga vdekja e nënës, referuar veprimit të depozitimit bankar në llogarinë e përbashkët të subjektit dhe bashkëshortit të saj.

**29.3.** Në lidhje me burimet e krijimit të kësaj depozite, Komisioni iu referua dokumentacionit të administruar nga dosja e hetimit<sup>21</sup>, nga ku rezulton se vetëm me të ardhurat nga pensioni i babait dhe nënës së subjektit për periudhën janar 1998 - shtator 2004, në shumën rreth 900,000 lekë, pa zbritur shpenzimet jetike të tyre, prindërit ishin në pamundësi për të krijuar depozitën në shumën prej 1,000,000 lekësh.

**29.4.** Bazuar në këto konstatime, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për sa rezultoi se: a) nuk provohet burimi i të ardhurave që kishin shërbyer për krijimin e depozitës prej 1,066,362 lekësh; b) referuar dokumentacionit të administruar nga Komisioni, rezultoi se babai dhe nëna e subjektit kanë qenë në pamundësi financiare për krijimin e depozitës në shumën prej 1,066,362 lekësh; c) nuk provohet me dokumentacion ligjor disponimi nga subjekti i rivlerësimit si titullare e vetme e depozitës prej 1,066,362 lekësh.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**30.** Në prapësimet e dërguara, subjekti ka shpjeguar se burimet e krijimit të depozitës së të ndjerës M.H kanë qenë fillimisht të ardhurat nga puna e saj ndër vite dhe kursimet të cilat i ka pasur të depozituara në ish-Bankën e Kursimeve të Shqipërisë, në një llogari rrjedhëse (depozitë), duke filluar nga viti 1993, kohë kur subjekti ka qenë studente.

<sup>21</sup> Shih shkresat e ISSH-së në dosjen e ILDKPKI-së.

**30.1.** Subjekti ka pretenduar se duhet të përfshihen në analizë edhe pagat e saj përpara martesës në periudhën 1996 – 2003 kur ka jetuar me prindërit, ku kontributi i pagës së saj është kursyer në familje dhe nuk ka pasur kursime familjare dhe as llogari bankare përpara martesë. Gjithashtu, në këtë analizë duhet të përfshihen edhe të ardhurat nga pensioni i prindërve të saj përpara vitit 1998.

**30.2.** Në përfundim të shpjegimeve në lidhje me burimet e krijimit të depozitës, ajo ka kërkuar të rivlerësohen nga Komisioni burimet që kanë shërbyer për krijimin e depozitës, duke përfshirë, përveç pensioneve të prindërve, edhe të ardhurat e saj nga paga të përfituara për periudhën 1998 -2003, duke arsyetuar se me të ardhurat e përfituara pas zbritjes së shpenzimeve jetike (sa 50% e pagës), prindërit e saj do të kishin mundësi të kursenin shumën prej 1,704,091 lekë. Subjekti ka paraqitur një analizë në mbështetje të kësaj kërkesë.

**30.3.** Në lidhje me disponimin e depozitës si titullare e vetme, subjekti ka shpjeguar se bashkë me babain e saj kanë qenë të vetmit trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë të së ndjerës M.H. Me prokurën e posaçme noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.10.2004, babai i saj, i ndjeri J.H, i ka dhënë tagër të plotë disponimi mbi depozitën, bashkëshortit të saj z. A.Dh. Subjekti ka shpjeguar se ka jetuar bashkë me babain e saj prej vitit 2005 deri në vitin 2012, vit në cilin ai ka ndërruar jetë. Duke qenë fëmijë i vetëm, e gjithë përgjegjësia për kujdesjen ndaj tij dhe përballimin e shpenzimeve ka qenë në ngarkimin e saj. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se nuk ka pasur asnjë mosmarrëveshje gjyqësore ose jashtëgjyqësore mes saj dhe babait të saj lidhur me këtë depozitë.

**30.4.** Për të provuar shpjegimet e dhëna, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provave:

i) vërtetimi i datës 29.10.2021 lëshuar nga “Raiffeisen Bank” sh. a., Dega Lushnjë, në të cilën pasqyrohet se znj. M.H ka pasur të hapur llogari depozite kursimi në ish-Bankën e Kursimeve që prej datës 9.2.1993, por nuk ka të dhëna në lidhje me datën e mbylljes së saj, pasi inventarët e depozitave të ish- Bankës së Kursimeve Lushnjë fillojnë nga viti 1995. Gjithashtu, vërtetohet se znj. M.H ka qenë depozituese në periudhën 2000-2001 në një llogari kursimi, për të cilën nuk ka të dhëna në lidhje me datën e mbylljes së saj. Për këtë llogari, rezulton se gjendja e llogarisë në datën 31.12.2000 ka qenë 200,000 lekë dhe në datën 31.12.2001 ka qenë 524,095 lekë.

ii) vërtetim për bazën e vlerësueshme, lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Dega Rajonale Fier, me anë të së cilës vërtetohet punësimi i subjektit të rivlerësimit në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive Lushnjë për periudhën shtator 1996 - tetor 1998. Të ardhurat e përfituara nga paga në total rezultojnë në vlerën 365,362 lekë.

iii) prokurë e posaçme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.10.2004, sipas së cilës deklarohet se subjekti dhe babai i saj, J.H, në cilësinë e trashëgimtarëve të radhës së parë, sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Lushnjë, me nr. \*\*\*, datë 8.9.2004, i ka dhënë tagër personit të lidhur A.Dh për të tërhequr pranë Bankës së Kursimeve, Dega Lushnjë, shumën e depozituar në emër të të ndjerës M.H.

iv) certifikatë familjare nr. \*\*\*, lëshuar në datën 20.10.2016 nga zyra e gjendjes civile Lushnjë, sipas së cilës vërtetohet se gjendja familjare në periudhën 1998 deri në 2003 ka qenë J.H, M.H dhe Saemira Hila.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**31.** Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet e subjektit dhe shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur, vlerëson si burim të mundshëm financiar për krijimin e depozitës të trashëguar nga e ëma, përveç pensioneve të prindërve, edhe pagat e subjektit të rivlerësimit të përfituara nga punësimi për periudhën kohore 1996-2003, të provuara me dokumentacion ligjor, për sa

subjekti provoi se ka qenë në të njëjtin trug familjar me prindërit e saj. Nga analizimi në tërësi i burimeve të krijimit të provuara nga subjekti, pas kalimit të barrës së provës, trupi gjykues arrin në përfundimin se prindërit e subjektit kanë pasur mundësi financiare për krijimin e depozitës me burime të ligjshme.

**31.1.** Për sa i takon gëzimit nga subjekti të depozitës së trashëguar nga nëna e saj, znj.M.H, subjekti i rivlerësimit paraqiti në cilësinë e provës aktin noterial, të referuar në veprimin bankar të tërheqjes së parave nga llogaria e të ndjerës, pra, prokurën e datës 8.10.2004. Sipas prokurorës, subjekti, bashkë me babain e saj, z. J.H, në cilësinë e trashigimtarëve të vetëm ligjorë të së ndjerës znj. M.H, kanë autorizuar z. A.Dh, bashkëshortin e subjektit, për kryerjen e veprimit të tërheqjes së depozitës bankare të krijuar nga e ndjera. Rezulton se kjo depozitë është tërhequr në datën 29.12.2004 pranë ish-Bankës së Kursimeve nga bashkëshorti i subjektit për t'u depozituar më pas, në të njëjtën ditë, në të njëjtën bankë, në llogarinë e përbashkët të depozitës së subjektit dhe bashkëshortit të saj.

**31.2.** Trupi gjykues nga analizimi i këtij akti, si dhe shpjegimeve të subjektit, vlerëson se, pavarësisht se i ndjeri J.H nuk ka autorizuar shprehimisht veprimet e depozitimit të depozitës së trashëguar nga e ndjera M.H në llogarinë e përbashkët të subjektit dhe bashkëshortit të saj, ka autorizuar veprimin e tërheqjes së plotë të kësaj depozite dhe nga ana tjetër, duke konsideruar deklarinimin<sup>22</sup> e subjektit se babai ka bashkëjetuar me të dhe familjen e saj, pas vdekjes së të ndjerës, si dhe shpjegimeve të subjektit se nuk ka pasur mosmarrëveshje me babain në lidhje me këtë depozitë, krijohet bindja se babai i subjektit ka qenë në dijeni të administrimit të depozitës nga subjekti i rivlerësimit si fëmijë i vetëm i familjes Hila.

## **ii) Burimi i dytë- të ardhurat nga puna e bashkëshortit, z. A.Dh**

**32.** Nga analizimi i deklarinimit të subjektit në DIPP/2004, rezulton se shuma prej 1,000,485 lekësh, që përfaqëson pjesën tjetër të depozitës të vitit 2004, është depozita e krijuar nga personi i lidhur me subjektin nga punësimi i tij, e cila, nga hetimi rezulton se ka qenë ekzistuese në emër të tij në ish- Bankën e Kursimeve (tashmë “Raiffeisen Bank”).

**32.1.** Komisioni ka analizuar burimet e krijimit të kësaj depozite, duke konsideruar dokumentacionin e paraqitur nga subjekti<sup>23</sup> në formën e kërkuar sipas ligjit, të përkthyer dhe apostiluar, emërtuar “INPS”, datë 21.2.2020, për të provuar punësimin e bashkëshortit të saj në Itali për periudhën nga data 8.3.1996 - 1.1.2007, si dhe dokumentacionin e siguruar nga hetimi administrativ<sup>24</sup> në lidhje me të ardhurat e përfituara nga punësimi i tij si stomatolog në Shqipëri për periudhën 2003-2004.

**32.2.** Nga analizimi në tërësi i dokumentacionit për të ardhurat e siguruara nga punësimi në shtetin italian referuar periudhës 1996 - 2002 dhe 2004 (pasi në vitin 2003 bashkëshorti i subjektit nuk rezulton të ketë përfituar të ardhura në shtetin italian), si dhe dokumentacionit në lidhje me të ardhurat nga vetëpunësimi si stomatolog në vitet 2003-2004, rezulton se personi i lidhur ka pasur mundësi për krijimin e depozitës prej 1,000,485 lekësh, deklaruar nga subjekti në DIPP/2004.

## **iii) Shtimi i depozitës në vitin 2005**

**33.** Në DIPP/2005, në seksionin e interesave privatë, subjekti ka deklaruar “...*Bono thesari në Banka e Shqipërisë rrethi Lushnjë, në dy ankande të organizuara në dt 22.12.2005 në shumën*

---

<sup>22</sup>Në përgjigje të pyetësorit të parë, pika 1.4., subjekti ka deklaruar se ka banuar familjarisht në banesën e ndodhur në lagjen “\*\*\*”, Lushnjë, në pronësi të babait të saj, deri në 1 vit e gjysmë pas vdekjes së babait të saj.

<sup>23</sup> Në përgjigje të pyetësorit të dytë dërguar nga subjekti në datën 20.6.2021.

<sup>24</sup> Nga hetimi i kryer me shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 20.5.2020, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, si dhe deklarinimet e subjektit gjatë hetimit administrativ në lidhje me fitimin e bashkëshortit të saj.

**2,500,000 lekë, ankandi dt 20.01.2006, shuma 1,000,000 lekë”.** Pjesa takuese” 50%. “Bashkëshorti A.Dh, nga puna e tij si emigrant në Itali, nga viti 1993-2002 ka kursyer dhe **këtë shumë** ja kishte dhënë hua vëllezërve të tij, E e A.Dh. Njëri prej tyre E.Dh kishte blerë në emër të tij, por me të hollat e kursyera nga bashkëshorti im A, një apartament në fshatin P, komuna G, Lushnjë. Me kontratë të vitit 2005 kunati im shiti shtëpinë dhe të hollat e përfituara prej saj ja ktheu bashkëshortit tim. Gjithashtu dy kunetërit e mi A e E i kthyen bashkëshortit tim dhe pjesën tjetër të huasë në total 3,000,000 lekë dhe shumën prej 500,000 lekë u kursye nga të ardhurat nga puna jonë...”

**33.1.** Nga hetimi bankar rezultuan këto fakte: Banka e Shqipërisë<sup>25</sup> informon se në datën 16.12.2005 bashkëshorti i subjektit ka investuar në bono thesari në shumën 2,500,000 lekë. Ndërsa, “Tirana Bank”<sup>26</sup> informon se në llogarinë e personit të lidhur A.DH janë kryer dy depozitime: përkatësisht, në datën 17.6.2005 është depozituar *cash* në këtë llogari shuma prej 300,000 lekësh dhe në vijim, në datën 30.11.2005, shuma 600,000 lekë me përshkrimin “*derdhur nga I.M për blerje shtëpie*”. Pra, nga hetimi bankar, rezultoi se përgjatë vitit 2005 subjekti dhe personi i lidhur me të kanë shtuar pasurinë në formë likuiditetesh bankare në total në vlerën 3,400,000 lekë.

**33.2.** Më tej, nga hetimi ka rezultuar se shumat prej 600,000 dhe 300,000 lekësh janë tërhequr *cash* në datat 4 dhe 5 janar 2006 dhe në datën 16.1.2006 bashkëshorti i subjektit ka depozituar shumën 920,000 lekë, duke e investuar në bono thesari pranë Bankës së Shqipërisë.

**33.3.** Konstatohet se subjekti nuk ka deklaruar depozitën e krijuar në vitin 2005 pranë “Tirana Bank” me gjendje në fund të vitit në shumën 900,000 lekë.

**33.4.** E pyetur nga ILDKPKI-ja<sup>27</sup> në lidhje me mosdeklarimin e depozitës së krijuar në “Tirana Bank”, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar, ndër të tjera, se: “...Në vitin 1998, bashkëshorti ka dërguar likuiditete në Shqipëri dhe vëllai i tij, siç theksova më lart, bleu tokën dhe apartamentin, për llogari të bashkëshortit. Në vitin 2005 apartamenti është shitur dhe shuma e përfutuar është depozituar pranë Tirana Bank, në dy depozita të konstatuara edhe nga ju. Kam paraqitur kontratën e shitjes së apartamentit në shumën 1,000,000 lekë. Kam paraqitur edhe kontratën e blerjes së apartamentit, në vitin 1998. Depozitat bankare në Tirana Bank, janë tërhequr në vitin 2006 dhe janë shtuar në bono thesari...”

**33.5.** E pyetur, gjithashtu, në lidhje me burimet e krijimit të depozitave, subjekti ka deklaruar para ILDKPKI-së: “...Për të ardhurat e krijuara nga bashkëshorti në Itali, po paraqes për tu administruar në dosje kopje të formularit nga sigurimet shoqërore në Itali, që vërteton se bashkëshorti ka qënë me dokumenta të rregullta në Itali dhe ka krijuar të ardhura. Fillimisht bashkëshorti ka qënë pa dokumenta në Itali dhe me daljen e ligjit në vitin 1996, është bërë më dokumente të rregullta nga shteti Italian, dokumente të cilat i zotëron dhe aktualisht. **Përsa i përket mosdeklarimit të huadhënies në vitin 2004, është një pasaktësi në deklaram.** Për të verifikuar këtë huadhënie, do të paraqes akt ligjor provues. Lidhur me bonot e thesarit burimi i krijimit është puna e bashkëshortit në Itali.”

**33.6.** Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provave<sup>28</sup>: i) dokument në gjuhë të huaj nga INPS<sup>29</sup> ekstrakt i llogarisë së sigurimeve shoqërore për personin e lidhur A.Dh, për periudhën 8.3.1996 – 7.3.2007; ii) deklaratë e thjeshtë<sup>30</sup> datë 4.5.2015 nga A dhe E.Dh për konfirmimin e kthimit

<sup>25</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 10.3.2020 nga Banka e Shqipërisë dhe nxjerrja e llogarisë së subjektit në Bankën e Shqipërisë në përgjigje të ILDKPKI-së shkresa nr. \*\*\* prot., datë 28.6.2021.

<sup>26</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 5.3.2020 lëshuar nga “Tirana Bank”.

<sup>27</sup> Procesverbali datë 29.4.2015, përgjigjja e pyetjes nr. 6 në kthim përgjigjen nr. \*\*\* prot., datë 18.6.2021.

<sup>28</sup> Dokumentacion dërguar nga ILDKPKI me shpresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\*, datë 18.6.2021.

<sup>29</sup> Dokumentacioni është paraqitur në formën e kërkuar ligjore edhe në pyetësorin nr. 2.

<sup>30</sup> Dokumentacion dërguar nga ILDKPKI-ja me shpresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 18.6.2021.

të shumës prej 20,000 eurosh ndaj personit të lidhur, në vitin 2004; iii) kontratë shitjeje pasurie e paluajtshme, midis shitësit Th.Rr dhe blerësit E.Dh, të datës 24.08.1998, për blerjen e një pasurie tip “apartament” me sipërfaqe 73 m<sup>2</sup>, në fshatin P, Lushnjë; iv) kontratë shitjeje pasurie e paluajtshme, midis shitësit E.Dh dhe blerësit I.M, të datës 9.11.2005, për shitjen e apartamentit me sipërfaqe 73 m<sup>2</sup>, në vlerën 1,000,000 lekë; v) kopje të nxjerrjes së llogarisë së personit të lidhur A.Dh, në “Tirana Bank” për depozitimin e shumës 300,000 lekë në datën 17.06.2005 dhe shumës 600,000 lekë në datën 15.12.2005 me përshkrimin “*Depozitim nga I.M për blerje shtëpie*”, si dhe tërheqjet respektive të shumave 600,000 lekë dhe 300,000 lekë në datën 4 dhe 5 janar 2006; vi) kopje formulari të nxjerrjes së llogarisë të personit të lidhur A.Dh në Bankën e Shqipërisë, ku në datën 16.1.2006 depozitohet shuma prej 920,000 lekësh.

**33.7.** Bazuar në nenin 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni administroi në cilësinë e provave deklaratimet e subjektit dhe dokumentacionin justifikues të dorëzuar më parë në ILDKPKI në lidhje me burimet e krijimit të depozitave përgjatë vitit 2005.

**33.8.** Nga analizimi i këtij dokumentacioni, vihet re se në datën 4.5.2015, shtetasit A.DH dhe E.DH kanë lëshuar një deklaratë të thjeshtë, sipas së cilës deklarohet se vëllai i tyre z. A.Dh u ka lënë në ruajtje në vitin 2000 shumën prej 20,000 eurosh, me qëllim përdorimi për motive familjare, të cilën ia kanë kthyer në vitin 2004, deklaram i cili rezultoi se nuk përputhej me deklaramin e subjektit në DIPP/ 2005, ku është deklaruar se huaja e dhënë është kthyer nga vëllazërit e bashkëshortit në vitin 2005.

**33.9.** Për më tepër, nga administrimi i këtij dokumentacioni, u konstatua se referuar kontratës së shitblerjes së datës 24.08.1998, blerja e shtëpisë nga vëllai i bashkëshortit z. E.Dh ishte kryer më herët sesa huaja e marrë nga ai në vitin 2000, bazuar në deklaratën e lëshuar nga huamarrësit.

**33.10.** Mbi bazën e konstatimeve të rezultuara nga hetimi i Komisionit në lidhje me mospërputhjen e fakteve me deklaramin e subjektit për dhënien dhe kthimin e huas, u përgatit analiza financiare për mundësinë e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të për të investuar në bono thesari në shumën 2,500,000 lekë në Bankën e Shqipërisë dhe depozitimin në shumën 900,000 lekë në “Tirana Bank” në vitin 2005, duke u bazuar vetëm në të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit për periudhën 1.1.2005 – 31.12.2005.

**33.11.** Nga analiza financiare rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar investimet e kryera dhe depozitimin e kësaj shume, duke rezultuar me një balancë negative prej -1,883,313 lekësh.

**33.12.** Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, për sa u konstatuan mospërputhje të deklaramit të subjektit në DIPP 2005 me faktet e rezultuara nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit administrativ, në lidhje me: i) kohën e dhënies së huas dhe kthimin e saj, pasi subjekti e ka deklaruar huan para ILDKPKI-së<sup>31</sup> në vitin 2004, ndërkohë sipas DIPP 2005 huaja është kthyer në vitin 2005, por, referuar deklaratës së lëshuar nga huamarrësit citohet se huaja është marrë në vitin 2000 dhe është kthyer në vitin 2004; ii) apartamenti rezultoi i blerë para dhënies së huas, referuar kontratës së shitblerjes së datës 24.08.1998, ndërkohë subjekti ka deklaruar në DIPP/2005 se huaja është përdorur për blerje apartamenti; iii) ka mospërputhje në lidhje me shumën e pretenduar të dhënë hua, pasi subjekti ka deklaruar në DIPP/2005 huadhënien në total në shumën 3,000,000 lekë, ndërsa referuar deklaratës së huamarrësve të datës 4.5.2015 shuma e marrë hua është në vlerën 20,000 euro; iv) subjekti dhe personi i lidhur me të, nuk

---

<sup>31</sup> Pyetur nga ILDKPKI në datën 29.4.2015.

kanë deklaruar në deklaratën periodike vjetore 2004, dhënien e huas ndaj vëllezërve të bashkëshortit; v) subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar në DIPP/2005 depozitën e krijuar në shumën 900,000 lekë në “Tirana Bank” në emër të bashkëshortit dhe as burimin e krijimit të kësaj shume; vi) nga analiza financiare rezulton se subjekti dhe personi i lidhur janë në pamjaftueshmëri financiare në shumën -1,883,313 lekë për të justifikuar investimet në bono thesari dhe depozitën në “Tirana Bank” përgjatë vitit 2005.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**34.** Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e saj paraqiti një përmbledhje të fakteve në lidhje me punësimin e bashkëshortit të saj, z. A.Dh, si emigrant në Itali, që nga viti 1993 e në vijim. Për periudhën 1993-1996 shpjegoi se punësimi i tij nuk i është njohur nga shteti italian, ndonëse ka punuar dhe është paguar efektivisht dhe të ardhurat e fituara në formën e pagës, i ka kursyer (rreth 3,000,000 lekë), të cilën ua ka dhënë vëllezërve të tij. Nga këto kursime, ai ka paguar çmimin e apartamentit dhe tokës së blerë nga shtetasi Th.Rr në vitin 1998 dhe pjesa tjetër prej 20,000 euro është mbajtur e përdorur nga vëllezërit e tij A e E.Dh deri në vitin 2005. Subjekti ka shpjeguar se bashkëshorti i saj nuk ka pasur shpenzime qiraje dhe as shpenzime për energji, ujë dhe gaz, por ka jetuar pranë qendrës së punës, duke shpjeguar përkatësisht për secilën periudhë qëndrimi në lidhje me këtë fakt, si dhe nuk ka poseduar asnjë automjet deri në vitin 1999, duke shpjeguar se ky fakt provohet me dëshminë e aftësisë për drejtimin e automjeteve nxjerrë nga autoritetet italiane në muajin maj 1999.

**34.1.** Në lidhje me mospërputhjet e fakteve, subjekti ka shpjeguar se deklarata e lëshuar nga kunetërit (huamarrësit), sipas të cilëve huaja është marrë në vitin 2000 dhe është kthyer në vitin 2004, është pjesërisht e pasaktë, sa i përket kohës së kthimit përfundimtar të huas, pasi u është kërkuar në kushtet e urgjencës dhe në kuadër të procesit të rivlerësimit plotësimi i një deklaratë afërsisht 10 vite më vonë se shlyerja përfundimtare e huas prej 20,000 eurosh. Shënimi në emailin e dërguar të vitit 2004, në vend të vitit 2005, ka qenë lapsus i vëllezërve të bashkëshortit. Subjekti ka shpjeguar se bashkëshorti me vëllezërit kanë marrëdhënie të posaçme dhe ata kanë ndihmuar shpesh njëri-tjetrin në momente vështirësie financiare, duke qenë korrekt në shlyerjen e detyrimeve pa qenë e nevojshme prova me shkresë. Sipas subjektit, edhe ligjvënësi toleron respektimin e anës formale (prova me shkresë) për provueshmërinë e një marrëdhënieje juridiko-civile, në të cilën palët janë në marrëdhënie të posaçme (Neni 233, germa “ç” e Kodit të Procedurës Civile), si në rastin konkret ku, për shkak të lidhjes së afërt të gjakut, asnjëherë nuk është parë e nevojshme nënshkrimi i shkresave të thjeshta apo zyrtare për të provuar detyrime të ndryshme që kanë patur ndaj njëri-tjetrit, para dhe gjatë martesë. Në përfundim, subjekti ka shpjeguar se deklarata është bërë në kushte shpejtësie nga vëllezërit e bashkëshortit dhe se ato janë gati ta deklarojnë para trupit gjykues.

**34.2.** Subjekti ka shpjeguar se shuma e kursyer për periudhën 1996-2000 nga bashkëshorti është një shumë më e madhe se 25,000 euro (ose afërsisht 3,000,000 lekë), pra, është e njëjta shumë me 3,000,000 lekë. Në këtë shumë përfshihet edhe shuma prej 710,000 lekësh, që përfaqëson çmimin e blerjes së apartamentit në P, Lushnjë, në vitin 1998. Këtë shumë bashkëshorti e ka sjellë në Shqipëri në vitin 1998 dhe me të është paguar çmimi i blerjes së apartamentit dhe tokës tek shitësit z. Th.Rr dhe familja e tij bujqësore, pasi kunati z. E. Dh në momentin e nënshkrimit të kontratës ka qenë 18 vjeç e disa muaj dhe është e qartë se nuk ka patur mundësi të dispononte 710,000 lekë. I vetmi person në familje, që kishte mundësi të zotëronte këtë shumë, sipas subjektit, ka qenë bashkëshorti i saj, i cili ka ndërmjetësuar shitjen.

**34.3.** Bonot e thesarit janë blerë me shumën e dhënë hua kunetërve prej 20,000 eurosh, të kthyer prej tyre në vitin 2005. Subjekti ka sqaruar ndër të tjera se për shkak të marrëdhënieve të posaçme të bashkëshortit me vëllezërit nuk është mbajtur ndonjë deklaratë e thjeshtë apo

noteriale mes tyre për të vërtetuar kohën e saktë të dhënies së saj. Në këto kushte, subjekti ka shpjeguar se nuk mund të deklarojë saktësisht kohën e dhënies së huas. Në lidhje me kthimin e huas subjekti ka shpjeguar se shuma është kthyer nga kunetërit në Shqipëri, gjatë kohës që ata vinin nga Italia. Në përfundim të shpjegimeve, subjekti ka shtuar për kthimin e huas edhe shtetas të tjerë, duke u shprehur se shumat janë sjellë në Shqipëri pjesë-pjesë dhe dorazi nga kunata e saj E.Dh dhe djali i hallës së bashkëshortit, E.P.B.

**34.4.** Në lidhje me mosdeklarimin e huadhënies në vitin 2004, subjekti ka sqaruar se ka përjetuar rrethana jetësore të rënda gjatë vitit 2004 si: ndërhyrja kirurgjikale në Itali e bashkëshortit të saj, vdekja e nënës, e ndjera M.H, rrethana këto që kanë ndikuar në mosdijeninë për shumën e kursyer e të dhënë hua kunetërve dhe, si rrjedhojë, edhe mosdeklarimi i saj sipas ligjit në DPV-në e vitit 2004, i cili është kryer menjëherë në vitin pasardhës në DPV/2005, sapo i është deklaruar nga bashkëshorti. Subjekti ka konkluduar se pasaktësitë në deklaratën e parë të pasurisë prej bashkëshortit vijnë për shkak se të ardhurat bashkëshorti i ka fituar përpara martesë, viti 2004 ishte viti i parë i deklarimit (vit në të cilin ndër të tjera u vërtetuan disa rrethana njëjësore) si dhe për faktin se 20 mijë Euro disponohej nga vëllezërit e tij, pra nuk ishte gjendje në shtëpi apo në llogaritë e tij bankare.

**34.5.** Në lidhje me mosdeklarimin në DIPP/2005 të depozitës në shumën prej 900,000 lekësh, të krijuar në “Tirana Bank”, subjekti ka shpjeguar se në këtë deklaratë ka deklaruar rrethanën jetësore se, kunati i saj E.Dh kishte blerë në emër të tij, por me të hollat e kursyera nga bashkëshorti i saj një apartament në fshatin P (P) Komuna G, Lushnjë, të cilin e shiti dhe të hollat e përfituara prej saj ia ktheu bashkëshortit të saj. Subjekti ka shpjeguar se deklarimi është i saktë, për sa kohë që çmimi i shitjes (pjesa më e madhe prej 600,000 lekë) është paguar nëpërmjet “Tirana Bank”, nga blerësi I.M në emër të bashkëshortit të saj dhe se çmimi i shitjes përcaktohet saktë edhe në kontratën noteriale të shitjes së apartamentit tek z. I.M.

**34.6.** Subjekti, në prapësimet e saj, ka pretenduar gjithashtu të përfshihet si e ardhur në formën e fitimit kapital nga shitja e apartamentit, edhe shuma prej 290,000 lekë, që vjen si fitim midis çmimit të blerjes dhe shitjes së realizuar për këtë pasuri. Pra, në përfundim, subjekti ka kërkuar të përfshihet në analizën financiare: a) shuma 3,000,000 lekë që bashkëshorti u ka dhënë vëllezërve *cash* për blerjen e shtëpisë; b) të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit, në shumën 290,000 lekë; si dhe c) të ardhurat e kursyera nga secili bashkëshort në vitet paraardhëse, me të cilat është krijuar edhe depozita 67,000 USD. Subjekti ka pretenduar se, nëse do të merren në konsideratë këto shuma të deklaruara në “Vetting”, ajo dhe bashkëshorti do të rezultonin me mundësi financiare pozitive.

**34.7.** Për të mbështetur pretendimet e saj, subjekti ka bashkëlidhur së bashku me prapësimet dokumentacion provues si vijon: i) shkresa nga OSSH-ja, me nr. \*\*\* prot, datë 19.10.2021, në të cilën citohet për një kontratë energjie elektrike në fshatin P, në emër të abonentit A. Dh dhe më pas transferuar tek I.M, me dokumentacionin bashkëlidhur faturë energjie elektrike në fshatin P, në emër të A.Dh për konsumin janar 2019, kërkesë pa të dhëna të plota date (datë..2.2019) nënshkruar nga shtetasi A.Dh për mbyllje kontrate energjie elektrike në fshatin P. Dokument, printim nga sistemi i FSHU-së për ndryshimin e emrit të abonentit I.M, datë 16.02.2019. Deklaratë, datë 16.2.2019 të shtetasit I.M, sipas së cilës ka deklaruar se ka në pronësi objektin me nr. \*\*\*, formular i OSHEE-së për ndryshim të dhënash të kontratës datë 16.02.2019, të nënshkruar nga shtetasi I.M. Faturë pagese për energji elektrike nga I.M për shtator 2021 për një kontratë të lidhur në fshatin P, Lushnjë; ii) certifikatë e datës 28.12.2019 e lëshuar nga Komuna V, Itali, për të vërtetuar adresat e regjistruara të shtetasit A.Dh në Itali, përkthyer në gjuhën shqipe dhe apostiluar në datën 16.11.2020; iii) certifikatë e datës

30.12.2019 e lëshuar nga Komuna V, Itali, për të vërtetuar adresat e regjistruara të shtetasit E.Dh në Itali, përkthyer në gjuhën shqipe dhe apostiluar në datën 16.11.2020; iv) deklaratë të llogarisë së sigurimeve shoqërore, lëshuar në datën 20.2.2020 në lidhje me të ardhurat për shtetasin A.Dh, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe apostiluar në datën 16.11.2020 për periudhën 1.3.2000-31.12.2019; v) deklaratë të llogarisë së sigurimeve shoqërore, lëshuar në datën 20.2.2020, në lidhje me të ardhurat për shtetasin E.Dh, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe apostiluar në datën 16.11.2020, për periudhën 1.3.2000-31.12.2019; vi) deklaratë pensioni, lëshuar në datën 2.5.2019 nga INPS e përkthyer në gjuhën shqipe dhe apostiluar në datën 16.11.2020, për pensionin e përfituar nga shtetasja N.Dh; vii) deklaratë e thjeshtë e datës 1.10.2021 E.Dh, për blerjen dhe shitjen e apartamentit në fshatin P, Lushnjë; viii) deklaratë noteriale me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.10.2021, nënshkruar nga shtetasit Th dhe Dh.Rr, sipas së cilës ndër të tjera kanë deklaruar në lidhje me shitjen e tokës arë dhe apartamentit në vitin 1998, kundrejt çmimit 710,000 lekë, për të cilin janë marrë vesh paraprakisht në vitin 1998 me z. A.Dh; ix) deklarata në gjuhën italiane e datës 21.10.2021, të përkthyer, por pa apostiluar, titulluar “Informacion për të ardhurat” për shtetasin A.Dh, për vitet tatimore 1998-2002; x) deklaratë e mungesës së debiteve për shtetasin A.Dh e datës 21.10.2021, lëshuar nga Agjencia e të Ardhurave Drejtoria Rajonale V, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe bileta e konfirmuar e datës 21.10.2021 nga Agjencia e të Ardhurave; xi) komunikim elektronik (e-mail) datë 17 dhe 18.10.2021 në gjuhën italiane dhe fotokopje të aktit në gjuhën italiane i quajtur “kontratë strehimi”, datë 24.9.1998, si dhe fotokopje të aktit në gjuhën italiane të datës 4.3.1996 i quajtur “komunikim i shitjes së objektit”, akte të paraqitura jo në formën e kërkuar sipas ligjit; xii) fotokopje leje drejtimi lëshuar nga shteti italian, paraqitur jo në formën e kërkuar sipas ligjit; xiii) akt në gjuhën italiane “*legal point*”, datë 22.10.2021, nënshkruar nga z. A.Dh, drejtuar Prefekturës së V për legalizim; xiiii) komunikim elektronik datë 13.10.2021 A.Dh në gjuhën italiane, për rezervim takimi në zyrën e V në datën 27.10.2021; xix) kërkesë për informacion datë 18.10.2021 nënshkruar nga z. A.Dh drejtuar Ambasadës Italiane në Tiranë.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**35.** Trupi gjykues, pasi shqyrtoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat me objektivitet, duke konsideruar me rezervë aktet e paraqitura jo në formën e kërkuar ligjore, sipas nenit 266 të K.Pr.C<sup>32</sup>, vlerëson se:

**35.1.** Ligji nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive” ka rregulluar detyrimin e subjekteve për deklarimin e pasurive, burimeve të krijimit, detyrimeve financiare të krijuara apo ndryshuara brenda vitit kalendarik, pra, nga data 1 janar deri më 31 dhjetor të vitit përkatës, detyrim i cili përfshin edhe anëtarët e tjerë të familjes së subjektit.

**35.2.** Nga hetimi administrativ rezultoi se subjekti ka filluar të deklarojë pasuri/interesa privatë/të ardhura bashkë me bashkëshortin e saj që nga DIPP/2004<sup>33</sup> e vijim, të cilat janë bërë objekt vlerësimi, në kuptim të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.

**35.3.** Në lidhje me shtimin e depozitave përgjatë vitit 2005, nga analiza e shpjegimeve dhe provave të paraqitura pas dërgimit të rezultateve të hetimit, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës mbi rezultatet e hetimit, për arsye si vijon:

---

<sup>32</sup> Neni 266 i K.Pr.C “*Kur shkresa është në gjuhë të huaj, ajo paraqitet bashkë me përkthimin e saj në gjuhë shqipe, të legalizuar nga ambasada apo konsullata përkatëse ose nga organi tjetër kompetent.*”

<sup>33</sup> Në deklaratën e vitit 2003 subjekti ka deklaruar e vetme.



**35.4.** Pretendimi i subjektit për mosdeklarimin e huadhënies në DIPP/2004, për shkak se shuma disponohej nga kunetërit e saj dhe nuk ishte gjendje *cash* në shtëpi apo në llogari bankare, është i pabazuar në ligj, pasi në bazë të nenit 4, pika 1, germa “d” të ligjit nr. 9049/2003, subjektet kanë pasur detyrimin të deklarojnë gjendjen deri në 31 dhjetor të vlerës së likuiditeteve, gjendje në *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj. Për rrjedhojë, në zbatim të kësaj dispozite, subjekti ka pasur detyrimin të deklarojë në deklaratën e vitit të krijimit huadhënien ndaj kunetërve, për të cilën ka deklaruar në DIPP/2005 se me të ardhurat nga kthimi i saj, ka kryer investimin në bono thesari.

**35.5.** Trupi gjykues vlerëson se mosdeklarimi në deklaratën e vitit përkatës të vlerave monetare të dhëna hua një të treti, nuk përbën pasaktësi (sikurse pretendon subjekti) dhe nuk mund të korrigjohet me deklarimin në vitin pasardhës, në rrethanat kur, këto vlera monetare janë bërë burim krijimi të një pasurie të krijuar më vonë. Trupi gjykues, gjithashtu, nuk i vlerëson bindëse shpjegimet e subjektit për mosdeklarim të huadhënies në vitin 2004, për shkak të përjetimit të disa rrethanave jetësore familjare gjatë këtij viti, që kanë ndikuar në mospasjen dijëni për shumën së kursyer, pasi nga hetimi rezultoi se subjekti ka deklaruar në DIPP/2004 pasuri të tjera sipas rubrikave përkatëse, e për rrjedhojë mund të deklaronte edhe këtë pasuri.

**35.6.** Trupi gjykues, në këtë kontekst, vlerëson të theksojë se, në mirëkuptim të rrethanave jetësore të përjetuara nga subjekti, nëse do të pranohej se subjekti në vitin 2004 nuk ka qenë në gjendje të njohë shumën e parave të kursyera nga puna e kryer e bashkëshortit të saj, atëherë ky fakt do të përbënte një rrethanë serioze për vënien në dyshim të veprimtarisë profesionale vendimmarrëse të subjektit, duke konsideruar faktin se në vitin 2004 subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

**35.7.** Subjekti, gjithashtu, nuk arriti të provojë të kundërtën e mospërputhjeve të fakteve që lidhen me kohën e dhënies dhe kthimin e huas, vlerën e saj dhe qëllimin e përdorimit. Pretendimi i subjektit se marrëdhënia e posaçme midis bashkëshortit të saj dhe vëllezërve të tij justifikon mosrespektimin e anës formale të njohjes së detyrimeve të krijuara midis tyre, në kuptim të nenit 233, germa “ç” e Kodit të Procedurës Civile, nuk është i bazuar dhe as nuk i përgjigjet fakteve të rezultuara nga hetimi, për arsye se kjo dispozitë rregullon rastet kur lejohet prova me dëshmitarë në një procedurë gjykimi për rrethana të përcaktuara me ligj, ku konkretisht, germa e referuar nga subjekti rregullon rastet kur për shkak të rrethanave, në të cilat është kryer veprimi juridik ose marrëdhëniet e posaçme të palëve, nuk ka qenë e mundur të merrej prova me shkrësë.

**35.8.** Në rastin konkret, deklarata e datës 5 maj 2015 përfaqëson vullnetin e vëllezërve të bashkëshortit të subjektit të formalizuar në formë shkrësore, e cila ka provuar faktin e marrjes në përdorim të një shume prej 20,000 eurosh në vitin 2000 nga bashkëshorti i subjektit me qëllim përdorimi për motive familjare dhe, për rrjedhojë, çdo lloj deklarate e lëshuar nga të njëjtët deklarues në cilësinë e dëshmitarëve, nuk do të kishte të njëjtën vlerë provuese për kohën e lëshimit. Nën dritën e këtyre rrethanave, trupi gjykues arrin në përfundimin se pretendimi i subjektit për ta bërë pjesërisht të pasaktë deklaratën e dhënë nga kunetërit e saj, në mënyrë që ata të thirren si dëshmitarë, përfaqëson një përpjekje të subjektit për të minuar vlerën e provës shkrësore, me qëllim nxjerrjen në pah të provës me dëshmitarë, për t’u mbrojtur për efekt të procesit të rivlerësimit.

**35.9.** Sikurse rezultoi nga hetimi, një fakt tjetër që prodhoi mospërputhje midis deklarimit të subjektit me dokumentacionin e administruar ishte qëllimi i përdorimit të huas. Referuar deklaratës së datës 5 maj 2015, vëllezërit e bashkëshortit të subjektit kanë deklaruar se shumën që kanë marrë në ruajtje, e kanë përdorur për motive familjare, ndërsa referuar DIPP/2005 subjekti ka deklaruar se me huan e dhënë kunetërve nga bashkëshorti i saj, njëri prej tyre,

shtetasi E.Dh kishte blerë një apartament në P, hua të cilën ia ktheu bashkëshortit me shitjen e këtij apartamenti.

**35.10.** Kontrata e shitjes me nr.\*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 24.8.1998, e paraqitur nga subjekti për të provuar blerjen e këtij apartamenti me huan e marrë, është lidhur midis shitësit Th.Rr dhe blerësit E.Dh, kundrejt vlerës 710,000 lekë, e paguar para përpilimit të kontratës, pra, përpara marrjes së huas në vitin 2000. Në shpjegimet përfundimtare, subjekti pretendoi se deklarata u është kërkuar kunetërve që të plotësohej në kushte urgjence. Ajo ka pretenduar se shtëpia është blerë nga bashkëshorti me të ardhurat e përfituara nga emigracioni, duke shpjeguar se shumën e blerjes e ka sjellë ai vetë në Shqipëri, ku dhe ka ndërmjetësuar me shitësin, me të cilin ka ndërtuar edhe marrëdhënien financiare, fakt ky i cili, sipas subjektit, provohet me pagesën në bankë “*derdhur nga I.M për blerje shtëpie*”. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi shpjegimet dhe administroi provat e paraqitura nga subjekti në vijim të rezultateve të hetimit, vlerëson se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën edhe për këto mospërputhje.

**35.11.** Deklarata e thjeshtë e datës 1.10.2021 e shtetasit E.Dh, paraqitur nga subjekti në cilësinë e provës, për të provuar se ky shtetas nuk ka pasur lidhje pronësie mbi apartamentin e blerë në vitin 1998, nuk provon se kjo pasuri është pronë e bashkëshortit të subjektit. Shtetasi E.Dh, ashtu edhe subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e saj, kanë deklaruar se apartamenti është blerë me paratë e kursyera të bashkëshortit të subjektit, i cili ka ndërmjetësuar për blerjen e tij dhe më pas, referuar deklaratës, ai është larguar në Itali, pasi e ka pasur të pamundur të qëndronte për nënshkrimin e kontratës, për arsye pune.

**35.12.** Trupi gjykues vlerëson se ky pretendim nuk është i bazuar në ligj, pasi, nëse bashkëshorti i subjektit ka pasur qëllim të blinte një apartament dhe ka ardhur nga Italia në Shqipëri në vitin 1998 për të ndërmjetësuar dhe paguar çmimin e blerjes, sikurse ka shpjeguar subjekti, nuk ka pasur asnjë pengesë të lëshonte edhe një prokurë të posaçme para se të largohej nga Shqipëria, ku të autorizonte vëllain e tij, shtetasin E.Dh, që të nënshkruante kontratën e blerjes së apartamentit në emër për llogari të tij. Për më tepër, përpjekjet e subjektit për të provuar të kundërtën e barrës së provës, duke e trajtuar kontratën e blerjes së apartamentit të datës 24.08.1998, si një kontratë e bërë në marrëveshje midis palëve, pa pasur qëllim të sjellë pasojën ligjore të blerjes nga shtetasi E.Dh, nuk i përshtaten aspak etikës profesionale të një subjekti magjistrat, i cili duhet t’i garantojë publikut zbatimin e normave ligjore.

**35.13.** Në lidhje me deklarimin për huan e dhënë, trupi gjykues vlerëson gjithashtu se subjekti ka ndryshuar deklarimin në shpjegimet përfundimtare, duke pasur për qëllim që t’i shkojë sa më afër deklaratës së lëshuar nga kunetërit e saj për shumën e marrë 20,000 euro, me qëllim justifikimin e investimit në bono thesari në shumën 2,500,000 lekë në vitin 2005, si dhe njëkohësisht, duke pasur si qëllim të veçojë huan nga fakti i blerjes së apartamentit, për shkak të mospërputhjes së elementit kohë. Subjekti, ndryshe nga sa ka deklaruar në DIPP/2005 se bashkëshorti i saj u ka dhënë vëllezërve të tij hua për blerjen e apartamentit, i cili nga hetimi rezultoi se ishte blerë përpara huas së dhënë, në shpjegimet përfundimtare ka deklaruar se paratë për blerjen e apartamentit në shumën prej 710,000 lekësh janë sjellë vetë nga bashkëshorti i saj në vitin 1998 dhe me të është paguar çmimi i blerjes. Subjekti ka deklaruar si hua të dhënë kunetërve të saj vetëm shumën 20,000 euro ose, sipas subjektit, kundërvlera në shumën rreth 2,500,000 lekë, pra, sa vlera e investimit në bono thesari. Duke i dhënë vlerë provuese deklarimit vjetor në DIPP/2005, bazuar në nenin 32 pika 5 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues çmon se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e mospërputhjeve të deklarimit me faktet e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit.

**35.14.** Në lidhje me kthimin e shumës së dhënë hua, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk arriti të provojë gjithashtu të kundërtën e mospërputhjeve midis deklaratës DIPP/2005 dhe deklaratës së lëshuar nga huamarrësit mbi kthimin e huas në vitin 2004, për sa në lidhje me

këtë fakt nuk ka një provë shkresore koherente që të provojë kthimin e saj. Shpjegimet e subjektit për kthimin e huas pjesë-pjesë, dorazi, nuk janë bindëse, duke konsideruar faktin se në këtë periudhë sistemi bankar po zhvillohej në Shqipëri<sup>34</sup> dhe se subjekti ka pasur detyrimin të provojë para ILDKPKI-së në lidhje me deklaratimet e kryera në deklaratat e pasurive.

**35.15.** Gjithashtu nga administrimi i shpjegimeve përfundimtare të subjektit dhe provave, konstatohet se ka deklarime kontradiktore për kthimin e shumës së huas. Subjekti, në fillim ka shpjeguar se shuma e huas i është dorëzuar dorazi dhe pjesë-pjesë bashkëshortit nga vëllezërit e tij në vitin 2005, duke theksuar se deklarimi për kthimin në vitin 2004 nga ana e tyre ka qenë lapsus. Ndërsa, në vijim të shpjegimeve, ka sqaruar se shumat janë sjellë në Shqipëri pjesë-pjesë nga kunati i saj A.Dh dhe bashkëshortja e tij E.Dh, si dhe kushëriri i bashkëshortit të saj, E.P.B, dorazi, gjatë vitit 2005. Trupi gjykues, konkludon se subjekti nuk arriti të provojë në lidhje me kthimin e huas, si dhe mbi mospërputhjet e deklarimeve për vitin e kthimit të kësaj huaje.

**35.16.** Trupi gjykues çmon gjithashtu se nga vlerësimi i bërë dokumentacionit të të ardhurave<sup>35</sup> të kunetërve të përfituara në Itali për periudhën 1.3.2000-31.12.2005, nuk mund të arrihet në një konkluzion për mundësinë financiare të tyre për kthimin e huas në vitin 2005, siç ka pretenduar subjekti, pasi mbi to duhet të llogariten shpenzimet jetike për numrin e familjarëve, shpenzimet e tjera dhe investimet e kryera përgjatë viteve, detyrimet ndaj të tretëve, mungesa e të cilëve e bën të pamundur analizën e treguesve financiarë.

**35.17.** Në përfundim, subjekti ka kërkuar që të përfshihet në analizën financiare të vitit 2005, shuma prej 3,000,000 lekë e kthyer nga kunetërit e saj, shuma prej 290,000 lekë në formën e fitimit kapital nga shitja e apartamentit, që vjen si fitim midis çmimit të blerjes dhe shitjes së realizuar për apartamentin, si dhe të ardhurat e kursyera nga secili bashkëshort në vitet paraardhëse. Trupi gjykues vlerëson se në analizën përfundimtare të vitit 2005 nuk mund të konsiderohet huaja e kthyer nga kunetërit e saj për arsyet e trajtuara gjerësisht më lart, si dhe as fitimi i pretenduar si i realizuar nga subjekti dhe bashkëshorti i saj nga shitja e apartamentit në shumën 290,000 lekë, pasi subjekti nuk arriti të provojë se apartamenti ishte blerë nga bashkëshorti i saj në vitin 1998 dhe i shitur nga ai në vitin 2005. Dokumentacioni i lidhjes së energjisë elektrike në emër të bashkëshortit të subjektit për apartamentin në P, nuk provon pronësinë e bashkëshortit të subjektit mbi të. Bazuar në nenin 690 të Kodit Civil kontrata ka forcën e ligjit për palët dhe nga hetimi rezultoi se blerja dhe shitja e shtëpisë ishte kryer nga vëllai i bashkëshortit të subjektit z. E.Dh.

**35.18.** Në analizën financiare të vitit 2005 janë konsideruar të ardhurat e përfituara nga bashkëshortët referuar dokumentacionit ligjor të administruar në dosjen e hetimit, si dhe e ardhura e përfitur nga bashkëshorti i subjektit në shumën 600,000 lekë në datën 15.12.2005<sup>36</sup>. Gjithashtu, në analizën financiare të këtij viti, sikundër dhe në vitet e tjera vijuese, subjektit i janë ngarkuar edhe shpenzimet jetike për babain e saj, bazuar në deklarin e subjektit se babai ka jetuar me të dhe familjen e saj deri para se të ndërronte jetë. Në përfundim të analizës financiare, rezultati për vitin 2005, nga -1,883,313 lekë shkon në **-1,392,870 lekë**.

---

<sup>34</sup> Shih "Historikun e bankave në Shqipëri" "në [www.ab.al](http://www.ab.al) dhe raportin "Banka Qendrore dhe sistemi bankar në Shqipëri në [www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org).

<sup>35</sup> Ekstrakti i datës 20.02.2020 lëshuar nga INPS.

<sup>36</sup> Referuar depozitimit bankar pranë "Tirana Bank" me përshkrimin "*Depozitim nga I.M për blerje shtëpie*".

**Tabela nr.1**

Analiza financiare përfundimtare e vitit 2005

	<b>2005</b>
<b>A) PASURI</b>	<b>3,237,203</b>
Ndryshim likuiditeti	3,237,203
<b>B) DETYRIME</b>	<b>0</b>
<b>C) PASURI NETO</b>	<b>3,237,203</b>
<b>D) TË ARDHURA (A-B)</b>	<b>2,470,790</b>
Të ardhura nga paga e SR	779,111
Të ardhura nga fitimi bashkëshortit të SR (Person Fizik Stomatolog)	1,000,476
Të ardhura nga bashkëshorti (depozituar në Tirana Bank)	600,000
Të ardhura nga interesat e Raiffeisen Bank	11,078
Të ardhura nga interesat e bono thesari	80,125
<b>E) SHPENZIME</b>	<b>626,457</b>
Shpenzime jetese	438,228
Shpenzime udhëtimi TIMS	88,229
Shpenzime për mobilim apartamenti në Lushnje	100,000
<b>Balanca e fondeve (D-C-E)</b>	<b>-1,392,870</b>

**35.19. Si konkluzion**, subjekti ka kryer deklarin të pamjaftueshëm në lidhje me burimet e krijimit të depozitave në vitin 2005, duke rezultuar me mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën prej **-1,392,870 lekë**, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

#### iv) Shtimi i depozitës në vitin 2006

**36.** Në DIPP/2006 subjekti ka deklaruar “...Interesi i depozitave në Raiffeisen Bank, në emrin tim në shumën totale prej 3,400,000 lekë (1,600,000 lekë dhe 1,800,000 lekë) ...” ...” ...Shtesë depozite nr. \*\*\* ishte 1,066,362 + 132,862 lekë, **pra shtuar vlera 132,862 lekë**, në masën 100%. Shtesë depozite nr. \*\*\* ishte 800,485 lekë+ 800,328 lekë) në Raiffeisen Bank, viti 2006. **Pra shtuar vlera 800,328 lekë**, në masën 100%. Ndërsa në DIPP/2007-2009, subjekti ka deklaruar mbi interesat e përfituara nga depozitat bankare.

**36.1.** Nga analizimi i deklarin të DIPP/2006, është konstatuar se subjekti ka deklaruar gjendje në llogaritë bankare në vlerën totale 3,400,000 lekë (vlerë e arrirë), por nuk ka deklaruar burimin e krijimit për pjesën e shtuar në këtë llogari.

**36.2.** Nga hetimi bankar<sup>37</sup> është konstatuar se gjatë vitit 2006 subjekti dhe personi i lidhur ka depozituar *cash* në “Raiffeisen Bank” shumën prej 1,300,000 lekë, përkatësisht në datën 16.8.2006 ka depozituar shumën prej 600,000 lekësh dhe në datën 6.12.2006 shumën prej 700,000 lekë, duke bërë që gjendja e depozitës në këtë bankë të arrijë nga vlera 5,326,000 lekë që ishte në fund të vitit 2005, në vlerën rreth 6,950,000 lekë në datën 31.12.2006. Nga analiza financiare e vitit 2006<sup>38</sup>, ka rezultuar se subjekti ka pasur mundësi financiare për të shtuar depozitat përgjatë vitit 2006.

**36.3.** Në përfundim, subjektit iu kërkuan shpjegime për sa nga hetimi rezultoi se nuk kishte deklaruar në DIPP/2006 shumën e shtuar prej 1,300,000 lekësh, si dhe në lidhje me mosdeklarimin e burimit të krijimit për fondet e shtuara në “Raiffeisen Bank”.

<sup>37</sup> Shkresë kthim përgjigjeje të “Raiffeisen Bank” me nr. \*\*\*, datë 12.3.2020.

<sup>38</sup> Shih analizën financiare përmblendhëse aneksi nr. \*\*\*, për ekonomi administrimi.

## **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**37.** Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se Komisioni ka konstatuar drejt pasaktësinë për mosdeklarimin e shumës së shtuar në depozitë, por këto shuma janë të pasqyruara në llogaritë bankare dhe kanë qenë lehtësisht të verifikueshme. Shuma e depozituar në datën 16.8.2006 në shumën 600,000 lekë dhe shuma e depozituar në datën 6.12.2006 në shumën 700,000 lekë është pikërisht fitimi i realizuar nga aktiviteti privat i bashkëshortit, i depozituar në bankë në dy periudha kohore. Subjekti ka konkluduar se duket qartë se pasaktësia është e paqëllimshme dhe nuk ka asgjë për të shmangur ose fshehur.

## **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**38.** Trupi gjykues, pas shqyrtimit të shpjegimeve të subjektit, vlerëson se mosdeklarimi në DIPP/2006 i shumës 1,300,000 lekë, si dhe i burimit të krijimit përbën pasaktësi dhe nuk mund të bëhet shkak për penalizimin e subjektit, në kuptim të nenit 61 pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për sa depozitimet provohen të jenë kryer nëpërmjet bankës dhe subjekti nuk ka pasur qëllim fshehjen e tyre.

## **Burimi i dytë: të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në Lushnjë, trashëguar nga prindërit e subjektit**

**39.** Referuar deklaratës “Vetting”, si burim krijimi të pasurisë objekt vlerësimi, subjekti ka deklaruar të ardhurat e fituara nga shitja e apartamentit të trashëguar nga prindërit, privatizuar me ligjin nr. 7652/1991.

## **Deklarimi i kësaj pasurie ndër vite**

**39.1.** Në DPV/2003, subjekti ka deklaruar pasurinë “apartament banimi”, i ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, apartamenti \*\*\*, nr. pasurie \*\*\*, në qytetin e Lushnjës. Apartamenti është ndërtuar në vitin 1971, me sip 55 m<sup>2</sup>, bashkëpronare me 33% pjesë takuese me prindërit e saj, me burim krijimi sipas ligjit “Për privatizimin e banesave shtetërore”. Në DIPP/2004 ka deklaruar 50% pjesë takuese mbi apartamentin. Në DIPP/2012 ka deklaruar se është pronare e vetme mbi pasurinë e trashëguar, sipas vendimit nr. \*\*\*, datë 21.12.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Ndërsa në DIPP/2014 ka deklaruar se e ka shitur me *kontratën e shitblerjes nr \*\*\* rep., nr \*\*\* kol datë 31.3.2014, kundrejt vlerës 3,600,000 lekë*. Gjithashtu, në seksionin e detyrimeve financiare të DIPP/2014 ka deklaruar se për shlyerjen e një pjese të kredisë së marrë për blerjen e apartamentit në Tiranë ka përdorur shumën prej 3,600,000 lekësh, përfituar nga shitja e apartamentit në Lushnjë. Gjithashtu, pasuria është deklaruar nga subjekti si adresë banimi në DIPP 2005-2011 dhe 2013.

## **Hetimi i kryer për këtë pasuri**

**39.2.** Komisioni ka hetuar në lidhje me mënyrën e përfitimit të këtij apartamenti, ku nga hetimi ka rezultuar se në datën 19.08.1993, me kontratën<sup>39</sup> e shitblerjes me nr. \*\*\* prot., babai i subjektit, i ndjeri z. J.H, ka blerë nga Komisioni i Privatizimit Lushnjë, një apartament me sipërfaqe 48 m<sup>2</sup>, ndodhur në hyrjen e parë, në katin e dytë të pallatit nr. \*\*\*, në lagjen “\*\*\*\*”, Lushnjë, kundrejt çmimit 4,635 lekë.

**39.3.** Në vijim, në datën 14.1.2000, prindërit e subjektit, bashkë me subjektin e rivlerësimit, kanë lidhur një kontratë shkëmbimi me shtetasit A.S dhe A.S për shkëmbimin midis tyre të apartamenteve të ndodhura në të njëjtin pallat, sipas të cilës subjekti dhe prindërit e saj kanë fituar pronësinë e apartamentit me sipërfaqe 55 m<sup>2</sup>, të ndodhur në katin e tretë, të cilin e kanë regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë dhe janë pajisur me

<sup>39</sup>Shih dokumentacionin bashkëlidhur shkresës dërguar nga ZVRPP-ja Lushnjë - kontrata e shitblerjes me nr. \*\*\*, datë 19.8.1993, dosja e ILDKPKI-së, Aneksi \*\*\*.

certifikatë pronësie<sup>40</sup> në datën 7.1.2003. Ndërsa shtetasit S kanë fituar pronësinë e apartamentit me sipërfaqe 48 m<sup>2</sup>, në katin e dytë.

**39.4.** Në datën 7.10.2004<sup>41</sup>, në regjistrin e pasurive të paluajtshme Lushnjë është regjistruar dëshmia e trashëgimisë<sup>42</sup> për të ndjerën M.H, me bashkëpronarë mbi pasurinë apartament 55 m<sup>2</sup>, subjekti i rivlerësimit dhe babai i saj J.H me nga ½ pjesë takuese secili.

**39.5.** Komisioni, ndër të tjera, e ka pyetur subjektin për arsyet e kryerjes së veprimit juridik të shkëmbimit të këtyre pasurive, e cila ka shpjeguar se në pallatin ku banonte është ndërtuar një shtesë ballore nga banorët, ku babai i saj do të përfitonte një shtesë prej 23 m<sup>2</sup> më tepër dhe në këto kushte kanë pranuar ndërrimin e apartamentit me fqinjët e pallatit, duke përfituar më pak hapësirë, por me një pozicion gjeografik ku ngrohej nga dielli. Për të provuar në lidhje me shtesën prej 23 m<sup>2</sup> subjekti ka paraqitur dokumentacion: 1) vendim të KRRT-së së Bashkisë Lushnjë nr.\*\*\*, datë 5.4.2005 në emër të z. J.H me planimetrinë bashkëlidhur; 2) leje ndërtimi për subjektin ndërtues “\*\*\*\*” sh.p.k., me vendim të KRRT-së nr.\*\*\*, datë 5.4.2005 për objektin shtesë ballore tek pallati nr. \*\*, për lokal tregtie, si dhe shtesë banese në lagjen “\*\*\*\*”; 3) projekt zbatimi i objektit pallati nr. \*\*, 4) leje shfrytëzimi e datës 10.11.2005; 5) vërtetim me nr. \*\* prot., datë 23.1.2006, lëshuar nga dega e Tatim-Taksave Lushnjë, sipas të cilit vërtetohet se z. J.H ka prishur kontratën e punës me subjektin “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe ka shlyer detyrimet tatimore që lindnin nga leja e ndërtimit e KRRT-së së Bashkisë Lushnjë me nr. \*\*, datë 5.4.2005; 6) plan rievilimi për sipërfaqe prej 23 m<sup>2</sup> shtesë anësore, kati i 3-të, me pronar J.H.

**39.6.** Më tej, nga administrimi i dokumentacionit në lidhje me ndërtimin e shtesës prej 23 m<sup>2</sup>, u konstatua se në datën 5.4.2005, është lëshuar një leje ndërtimi<sup>43</sup> në favor të J.H dhe 3 banorëve të tjerë të këtij pallati, për shtesë ballore apartamenti. Në datë 10.11.2005, është lëshuar leja e shfrytëzimit<sup>44</sup> për objektin shtesë ballore të pallatit \*\*, sipas projektit të zbatimit dhe në vijim është regjistruar në regjistrin hipotekor<sup>45</sup> me nr. \*\*, datë 20.1.2006 ndërtesa shtesë ballore me sipërfaqe prej 23 m<sup>2</sup> në pronësi të J.H.

**39.7.** Me lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë<sup>46</sup> nr. \*\*, datë 21.12.2012, subjekti ka regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme Lushnjë pasurinë “apartament” 55 m<sup>2</sup><sup>47</sup> dhe shtesë prej 23 m<sup>2</sup><sup>48</sup> në emër të saj si trashëgimtare e vetme ligjore në datën 28.1.2013.

**39.8.** Në datën 31.3.2014, me kontratën<sup>49</sup> e shitjes nr. \*\* rep., nr. \*\* kol., subjekti i rivlerësimit i ka shitur apartamentin me sipërfaqe 55 m<sup>2</sup> dhe shtesën e apartamentit prej 23 m<sup>2</sup> shtetasit Ll.Nd, kundrejt çmimit prej 3,600,000 lekë<sup>50</sup>, paguar para përpilimit të kontratës.

<sup>40</sup> Certifikata e pasurisë në emër të J, M dhe Saimira Hila, dosja e ILDKPKI-së.

<sup>41</sup> Certifikata e pronësisë në dosjen e ILDKPKI-së, Aneksi \*\*.

<sup>42</sup> Vendim të gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë nr. \*\*, datë 8.9.2004 në dosjen e ILDKPKI-së, Aneksi \*\*.

<sup>43</sup> Vërtetimi hipotekor në dosjen e ILDKPKI-së aneksi \*\*.

<sup>44</sup> Leja e shfrytëzimit për shtesën 23 m<sup>2</sup>, në kthim përgjigje të pyetësorit 2.

<sup>45</sup> Vërtetimi hipotekor në dosjen e ILDKPKI-së, aneksi \*\*.

<sup>46</sup> Vendim gjykate në dosjen e ILDKPKI-së, aneksi \*\*.

<sup>47</sup> Certifikata për vërtetim pronësie e datës 17.1.2013 në dosjen e ILDKPKI-së, aneksi \*\*.

<sup>48</sup> Vërtetim pronësie për pasurinë 23 m<sup>2</sup> (shtesa anësore) në emër të subjektit, dosja e ILDKPKI-së, aneksi \*\*.

<sup>49</sup> Kontrata e shitblerjes me nr. \*\* rep., nr. \*\* kol., datë 31.3.2014, dosja e ILDKPKI-së aneksi \*\*, faqe \*\*.

<sup>50</sup> Ku janë paguar në datën 1.4.2014 detyrimet tatimore mbi shumën sipas shkresës nr. \*\* prot., datë 28.6.2011 të ILDKPKI-së.

**39.9.** Në datën 8.4.2014, kjo pasuri<sup>51</sup> është regjistruar në emër të palës blerëse Ll dhe K. N.

**39.10.** Referuar dokumentacionit bankar<sup>52</sup>, konstatohet se në datën 2.4.2014, në llogari të subjektit është kredituar me transfertë, shuma prej 3,600,000 lekësh me përshkrimin “*Likujdim i plotë detyrim për blerje apartamenti nga Ll.N*”, shumë e cila është destinuar në datën 3.4.2014<sup>53</sup> për shlyerjen e pjeshme të kredisë së marrë nga subjekti pranë “Raiffeisen Bank” për blerjen e shtëpisë.

**39.11.** Nga analiza e fakteve dhe dokumentacionit të sipërcituar, subjektit i kaloi barra e provës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën në lidhje me konstatimet për sa rezultoi se: i) nuk përputhet deklarimi i subjektit në DIPP/2010 me atë “Vetting” në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë objekt vlerësimi, pasi në DIPP/2010 subjekti ka deklaruar si burim depozitë bankare dhe kredi, ndërsa në “Vetting” ka shtuar si burim edhe të ardhurat nga shitja e apartamentit të trashëguar nga prindërit; ii) subjekti ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën “Vetting” në lidhje me burimin e krijimit për blerjen e apartamentit në Tiranë me të ardhurat nga shitja e apartamentit të trashëguar nga prindërit, pasi nga hetimi rezultoi se këto të ardhura janë përfituar në datën 2.4.2014 dhe nuk mund të kenë shërbyer si burim krijimi për blerjen e pasurisë në vitin 2011; iii) subjekti nuk ka deklaruar pasurinë shtesë ndërtimi prej 23 m<sup>2</sup> në deklaratat periodike përkatëse, si bashkëpronare me të atin dhe pas vdekjes së tij, si trashëgimtare e vetme.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**40.** Subjekti ka shpjeguar se nuk ka pasaktësi në deklaratën “Vetting”, për shkak se shtimi si burim i të ardhurave të përfituara nga shitja e apartamentit të trashëguar nga prindërit, ka të bëjë me shlyerjen e kredisë, si një nga burimet kryesore të blerjes së apartamentit në momentin e kryerjes së pagesës. Subjekti ka pretenduar se interpretimi i asaj që ka deklaruar në deklaratën “Vetting” duhet të bëhet me qëllim që të sqarohet qëllimi i vërtetë i asaj që ka deklaruar, pa u ndalur në interpretimin letrar të fjalëve, si edhe duke vlerësuar rrethanat jetësore dhe sjelljen e saj në tërësi.

**40.1.** Lidhur me mosdeklarimin e shtesës së ndërtimit të apartamentit, subjekti ka shpjeguar se shtesa është realizuar në mënyrë të përligjur në zbatim të dispozitave të ligjit të kohës “Për Urbanistikën” dhe se nuk e ka ditur që dhoma shtesë dhe apartamenti bazë mbanin dy numra të ndryshëm pasurie, prandaj e ka trajtuar si një apartament të vetëm (2+1) deri kur ka dërguar për regjistrim në ish-ZVRPP Lushnjë “Dëshminë e trashëgimisë ligjore” të babait J.H. Subjekti ka shpjeguar se e ka deklaruar kalimin e të drejtës mbi këtë apartament në deklaratë periodike.

#### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**41.** Trupi gjykues, pas shqyrtimit të shpjegimeve të subjektit, çmon se në vlerësim të përpjekjeve të subjektit për të bërë deklarimin sa më gjithëpërfshirës në drejtim të burimeve të krijimit, pasaktësia e subjektit në deklarimin si burim krijimi të të ardhurave nga shitja e shtëpisë së trashëguar nga prindërit, nuk sjell pasoja penalizuese për të. Ky konkluzion vjen dhe si rrjedhojë e faktit se subjekti e ka destinuar shumën e përfituar nga shitja e shtëpisë për shlyerjen e kredisë. Pra, subjekti ka qenë në dijeni të burimit që ka shërbyer për këtë qëllim.

<sup>51</sup> Vërtetim hipotekor në dosjen e ILDKPKI-së aneksi \*\*\*, faqe \*\*\*.

<sup>52</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 12.3.2020, e “Raiffeisen Bank”. protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 10.4.2020.

**41.1.** Lidhur me mosdeklarimin nga subjekti të shtesës prej 23 m<sup>2</sup> në deklaratën e vitit kur ka fituar të drejta reale bashkë me babain dhe as si trashigimtare ligjore e vetme me vdekjen e tij, trupi gjykues nuk i vlerëson bindëse shpjegimet e subjektit. Pretendimi i subjektit se nuk e ka ditur që dhoma shtesë dhe apartamenti bazë mbanin dy numra të ndryshëm pasurie, prandaj e ka trajtuar si një apartament të vetëm (2+1), nuk qëndron dhe nuk justifikon mosdeklarimin, pasi subjekti, si palë përfituese, ka qenë në dijeni të sipërfaqes së apartamentit të fituar më parë me kontratë shkëmbimi në vitin 2000, apartament të cilit nga hetimi rezultoi se i ka ndryshuar më vonë sipërfaqja me ndërtimin e shtesës anësore. Megjithatë, trupi gjykues vlerëson se mosdeklarimi në deklaratat e viteve përkatëse të interesave privatë mbi shtesën 23 m<sup>2</sup>, nuk sjell si pasojë penalizimin e subjektit, në kuptim të nenit 61 pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për sa nga hetimi, shtesa rezultoi e regjistruar në pronësi të subjektit dhe se në DIPP/2014 ka deklaruar shitjen e saj prej 23 m<sup>2</sup> dhe të apartamentit prej 55 m<sup>2</sup> me kontratën e shitjes së datës 31.3.2014.

### **Burimi i tretë: kredia e marrë në “Raiffeisen Bank”, në shumën prej 5,023,807 lekësh**

**42.** Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur janë kredimarrës sipas kontratës së kredisë<sup>54</sup> datë 18.2.2011 në “Raiffeisen Bank”, për shumën prej 5,023,807 lekësh, me afat 15 vjet, me qëllim blerje apartamenti.

**42.1.** Kjo shumë është disbursuar në llogarinë e subjektit në datën 9.3.2011 dhe më pas në datën 10.3.2011 ka transferuar nga kjo llogari në favor të shoqërisë së ndërtimit “\*\*\*\*” sh.p.k., vlerën prej 5,000,000 lekësh, me përshkrimin “*Likujdim për blerje apartamenti*”. Si përfundim, në lidhje me këtë burim, trupi gjykues nuk konstatoi problematika.

### **Në lidhje me pagesën e çmimit të apartamentit**

**43.** Referuar kontratës paraprake të shitjes të datës 17.12.2010, si dhe kontratës së shitjes datë 15.2.2011, është përcaktuar se çmimi i blerjes së pasurisë “apartament” është në shumën 82,500 euro.

**43.1.** Në kontratën paraprake të shitjes është përcaktuar shlyerja e çmimit në këste: i) kësti i parë në shumën 25,000 euro është likuiduar nga pala blerëse në favor të palës shitëse jashtë kësaj zyrës noteriale; ii) kësti i dytë në shumën 57,500 euro do të shlyhej nëpërmjet një kredie që pala blerëse do të merrte pranë “Raiffeisen Bank”. Ndërsa, sipas kontratës së shitjes datë 15.2.2011, çmimi prej 82,500 euro është likuiduar jashtë zyrës noteriale.

### **Hetimi administrativ i kryer**

**44.** Komisioni i ka kërkuar<sup>55</sup> shoqërisë së ndërtimit “\*\*\*\*” sh.p.k., informacion në lidhje me modalitetet e pagesës së çmimit prej 82,500 euro, si dhe dokumentacion mbështetës, në vijim të së cilës shoqëria ka informuar<sup>56</sup> se disponon vetëm aktet e shitblerjes<sup>57</sup>, të cilat i ka vënë në dispozicion.

**44.1.** Më tej, nga hetimi administrativ<sup>58</sup> ka rezultuar se çmimi i apartamentit është paguar në tre këste, si vijon: i) në datën 17.12.2010 është paguar *cash* në arkën e shoqërisë, kësti i parë në vlerën 25,000 euro<sup>59</sup> ii) në datën 11.2.2011 është transferuar nga llogaria në euro në emër të

<sup>54</sup> Kontratë kredie nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.02.2011, pjesë e dokumentacionit të dërguar nga Raiffeisen Bank në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.03.2020, protokolluar në Komision me nr \*\*\* prot., datë 10.4.2020.

<sup>55</sup> Shkresë me nr. \*\*\* prot., datë 10.06.2021.

<sup>56</sup> Shkresë kthim përgjigje datë 17.06.2021 nga “\*\*\*\*”.

<sup>57</sup> Kontrate paraprake të shitblerjes datë 17.12.2010; kontratë shitjeje datë 15.2.2011; certifikatën e pronësisë në emër të shoqërisë; fotokopje të pasaportave; planimetri e apartamentit.

<sup>58</sup> Dokumentacioni i administruar nga dosja e ILDKPKI-së dhe dokumentacioni nga hetimi bankar i Komisionit

<sup>59</sup> Mandatarkëtimi i “\*\*\*\*” sh.p.k., datë 17.12.2010 paguar nga A.Dh shuma 25,000 euro. Mandati gjendet në shkresën e ILDKPKI-së, si pjesë e dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti në procesverbalet e mbajtur në ILDKPKI.



subjektit pranë “Raiffeisen Bank” shuma 20,000 euro<sup>60</sup>, në favor të shoqërisë; iii) në datën 10.03.2011, është transferuar në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., shuma prej 5,000,000 lekë (afërsisht 37,500 euro) me përshkrimin “likuidim për blerje apartamenti”, pas disbursimit të kredisë nga llogaria e kredisë në emër të subjektit në “Raiffeisen Bank”.

### **Në lidhje me pagesën e këstit të parë në shumën 25,000 euro**

**45.** Në DIPP/2010, subjekti ka deklaruar se *me kontratën paraprake të shitjes, ajo dhe bashkëshorti kanë paguar shumën 25,000 euro për blerjen e një apartamenti në zonën kadastrale \*\*\*, ndërsa shuma 57,500 euro do të paguhej me marrjen e një kredie nga “Raiffeisen Bank”, dega Lushnjë. Depozita bankare në dollarë amerikanë në këtë bankë, është tërhequr për t’u përdorur për blerjen e këtij apartamenti.*

**45.1.** Në pyetësin e parë<sup>61</sup>, subjekti ka deklaruar në lidhje me blerjen e apartamentit se *pagimi i çmimit për blerjen e apartamentit, në shumën prej 82,500 euro, është bërë me këste. Të ardhurat për blerjen janë siguruar nga të dy bashkëshortët në këto mënyra: së pari- të ardhurat e kursyera nga puna e secilit bashkëshort para dhe gjatë martesës ligjore. Këto kursime të përbashkëta të jetës së tyre deri në fund të vitit 2010, kanë qenë të gjitha të depozituara në “Raiffeisen Bank” sha, dega Lushnjë, me një kontratë depozite me afat maturimi 1 (një) vjeçar, afat i cili përfundonte në datën 21 dhjetor 2010.*

**45.2.** E pyetur nga Komisioni për mënyrën e pagesës së këstit të parë dhe burimin e të ardhurave, subjekti ka deklaruar<sup>62</sup> se kjo shumë nuk është paguar prej saj dhe bashkëshortit, por është parapaguar cash në zyrat e shoqërisë nga miqtë e tyre F dhe S.Q. Kjo për arsye se, depozita në shumën 67,000 dollarë amerikanë që ata kishin në “Raiffeisen Bank”, maturohej më 21.12.2010 (4 ditë më pas) dhe tërheqja e shumës, do të çonte në humbjen e interesave bankarë. Për këtë arsye kishin pajisur znj. S.Q me një prokurë noteriale për tëheqjen e depozitës së tyre në momentin e maturimit. Për më tepër, subjekti ka deklaruar se nuk kanë qenë në Shqipëri në këtë datë dhe janë kthyer, për sa kujton, në janar të vitit 2011.

**45.3.** Për të provuar deklarin, subjekti paraqiti në cilësinë e provave aktet: 1) deklaratë e thjeshtë e datës 28.4.2015 lëshuar nga shtetasit S dhe F.Q drejtuar ILDKPKI-së; 2) kontratë paraprake të shitjes datë 17.12.2010; 3) dokumentacion për përfitimin e të ardhurave nga subjekti dhe bashkëshorti i saj si stomatolog ndër vite, duke filluar nga viti 2003 e vijim si dhe atë përfituar nga punësimi në Itali për vitet 1996-2007, në formën e kërkuar nga ligji (me vulë Apostille dhe të përkthyer).

**45.4.** Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni rezultuan këto fakte: sipas deklaratës së datës 28.4.2015, shtetasit Q kanë deklaruar se kanë blerë një apartament në F, Tiranë, në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin kat me shtetasit Dh, H, miqtë e tyre. Në datën 17.12.2010, kur kanë paguar këstin e parë të tyrin në shumën prej 25,000 euro euro, kanë paguar gjithashtu edhe këstin e parë për çiftin Dh-H në të njëjtën shumë, për arsye se kishin një depozitë që maturohej disa ditë më vonë dhe nuk donin të humbisnin interesin. Meqenëse ata u larguan në Itali, nënshkruan një prokurë noteriale për znj. S.Q, me qëllim që ajo, në datën e maturimit 21.12.2010 të tërhiqte depozitën pranë “Raiffeisen Bank” dhe të merrte shumën e parapaguar në shumën 25,000 euro. Ajo ka deklaruar se, bazuar në prokurën e dhënë, ka tërhequr gjithë depozitën, të cilën ia ka dorëzuar bashkëshortit të saj z. F.Q, i cili pasi ka mbajtur shumën e parapaguar në favor të subjektit, pjesën tjetër të mbetur e ka përdorur për qëllime aktiviteti valutor dhe ia ka kthyer të konvertuar në euro, pra, në shumën 20,000 euro kur subjekti dhe bashkëshorti i saj janë kthyer nga Italia.

<sup>60</sup> Evidentuar në lëvizjet e llogarisë në shkresën kthim përgjigje të “Raiffeisen Bank” me nr. \*\*\*, datë 12.3.2020.

<sup>61</sup> Në përgjigje të pyetësorit nr. 1.

<sup>62</sup> Pyetësori nr. 2, pyetja nr. 1.

**45.5.** Më tej, ka rezultuar se në datën 17.12.2010 subjekti dhe personi i lidhur me të kanë nënshkruar një prokurë<sup>63</sup> për të emëruar si përfaqësuese të posaçme znj. S.Q, duke i dhënë të drejtë të tërheqë nga llogaria e tyre bankare në “Raiffeisen Bank”, të gjithë shumën në dollarë dhe të kryejë të gjitha procedurat e nevojshme, ligjore e administrative për lëvrimin e një kredie bankare në emër të A.Dh dhe Saemira Hila.

**45.6.** Nga hetimi bankar<sup>64</sup> ka rezultuar se në datën 21.12.2010 është tërhequr *cash* nga llogaria e personit të lidhur, z. A.Dh, shuma prej 67,000 dollarësh amerikanë me prokurën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.12.2010 nga znj. S.Q.

**45.7.** Në datën 17.12.2010 rezulton se është paguar shuma 25,000 euro referuar mandatarkëtimit<sup>65</sup> të lëshuar nga shitësi “\*\*\*\*” sh.p.k., me këto të dhëna: arkëtuar nga z. A.Dh, me përshkrimin “*likuidim pjesor për blerje apartamenti...*” dhe në vijim në datën 19.12.2010<sup>66</sup> subjekti dhe personi i lidhur me të janë larguar drejt Italisë.

**45.8.** Por, nga verifikimi i dokumentacionit bankar të “Raiffeisen Bank”<sup>67</sup> ka rezultuar se gjendja e llogarisë së bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në datën 17.12.2010 ka qenë 67,000 USD, fonde të cilat kanë qenë të lira për përdorim, pasi depozita është maturuar në datën 8.12.2010 dhe jo në datën 21.12.2010, siç ka deklaruar subjekti. Për më tepër, nga lëvizjet e llogarive është konstatuar se bashkëshorti i subjektit ka kryer edhe tërheqje *cash* në këtë llogari në datën 15.12.2010 në shumën 3,191 USD.

**45.9.** Komisioni përgatiti analizën financiare mbi mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të kryer pagesën e kështit të parë në shumën prej 25,000 euro në datën 17.12.2010, për sa u provua se subjekti nuk kishte përdorur depozitën e deklaruar në deklaratën e vitin të krijimit, DIPP/2010.

**45.10.** Nga analiza financiare, subjekti rezultoi në pamjaftueshmëri financiare në shumën - 4,088,943 lekë për të përballuar pagesën e kështit të parë prej 25,000 eurosh.

**45.11.** Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit për sa rezultoi se: i) nuk përputhet deklarimi i subjektit në DPV/2010 me deklaratimet e subjektit dhe dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ, në lidhje me pagesën e kështit të parë në shumën 25,000 euro me depozitë bankare në “Raiffeisen Bank”; ii) subjekti nuk ka deklaruar në DIPP/2010 si burim për pagesën e shumës 25,000 euro të ardhurat e shtetasve F dhe S.Q; iii) nuk provohet pagesa e shumës 25,000 euro nga shtetasit Q, përkundrazi me mandatin e datës 17.12.2010 vërtetohet se pagesa është kryer nga bashkëshorti i subjektit z. A.Dh; iv) nuk përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin bankar të administruar nga hetimi në lidhje me mosdisponimin e depozitës bankare në shumën 67,000 USD, për arsye maturimi deri në datën 21.12.2010, pasi nga hetimi bankar rezultoi se fondet ishin të lira prej datës 8.12.2010; v) subjekti nuk ka deklaruar në DIPP/2010 në lidhje me administrimin e depozitës prej 67,000 USD me prokurë nga të tretët, nga shtetasit F dhe S.Q, si dhe disponimin e saj pas tërheqjes deri në datën 31.12.2010; vi) mbi bazën e këtyre fakteve, Komisioni ngre dyshime të arsyeshme në lidhje me vërtetësinë e

---

<sup>63</sup> Prokurë e posaçme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\*, kol., datë 17.12.2010, pjesë e dokumentacionit të ardhur nga ILDKPKI-ja.

<sup>64</sup> Shkresë kthim përgjigjje nr. \*\*\* prot., datë 12.3.2020 e “Raiffeisen Bank”.

<sup>65</sup> Shih shkresën kthim përgjigjeje me nr. \*\*\* prot., datë 28.6.2021 të ILDKPKI-së. Mandati është pjesë e dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti në procesverbalet e mbajtura në ILDKPKI.

<sup>66</sup> Referuar të dhënave TIMS dërguar me shkresën me nr. \*\*\* prot., datë 12.3.2020, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

<sup>67</sup> Kthim përgjigje e “Raiffeisen Bank” me nr \*\*\*, datë 12.3.2020.

deklarimeve të subjektit për pagesën e shumës prej 25,000 euro nga shtetasit Q në favor të subjektit dhe personit të lidhur me të; vii) bazuar në nenin 3, pika 14 të ligjit nr. 84/2016, znj. S.Q dhe z. F.Q bëjnë pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, për shkak të lidhjes së interesit pasuror me subjektin për pagesën e shumës 25,000 euro dhe në bazë të nenit 32, pika 4, subjekti ka detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë për pagesën e kësaj shume; viii) nga analiza financiare e kryer në datën e pagesës së këstit të parë të shumës 25,000 euro, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesën e kësaj shume në datën 17.12.2010, duke rezultuar me balancë negative në shumën prej -4,088,943 lekësh.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**46.** Subjekti ka sqaruar se pasi ishin vënë në dijeni se shtetasit Q, me të cilët kanë marrëdhënie miqësore po shihnin mundësinë e blerjes së një apartamenti në Tiranë, kanë vendosur së bashku me bashkëshortin për të bërë të njëjtën gjë. Për këtë arsye kanë udhëtuar më 17 dhjetor 2010 për të diskutuar mbi kushtet dhe marrjen e një informacioni në zyrat e shoqërisë, ku edhe kanë gjetur bashkëshortët Q, të cilët së bashku me motrën e zotit F kishin vendosur për blerjen e apartamenteve. Përfaqësuesi i shoqërisë i ka informuar se duhet të paguanin të paktën një këst, në rast prenotimi dhe se këstet do të ishin më të ulëta nëse tri familjet do të blinin nga një apartament.

**46.1.** Në shpjegimet e saj, subjekti është ndalur tek pagesa e kryer nga shtetasit Q, duke theksuar se pagesa e këstit të parë prej 25,000 eurosh është kryer nga F.Q me propozimin e tij. Duke qenë se subjekti dhe bashkëshorti i saj nuk dispononin me vete të hollat, ai ishte gati të jepte një shumë të hollash nga gjendja që kishte me vete dhe të ulte këstin e tij për prenotimin e apartamentit. Bashkëshorti i subjektit pranoi propozimin dhe firmosi mandatin në zyrat e shoqërisë për likudimin e këstit në shumën 25,000 euro.

**46.2.** Të tria familjet (subjekti, F.Q dhe motra e tij) kanë nënshkruar kontratën paraprake të shitjes, të cilat janë regjistruar njëra pas tjetrës, duke i cituar njëra pas tjetrës, por nuk ka paraqitur dokumentacion provues për blerjen e shtëpisë nga motra e F.Q, sikurse pretendohet nga subjekti në shpjegimet e saj. Më tej, subjekti ka shpjeguar se F në datën 17 dhjetor 2010 pagoi këstin prej 13,000 eurosh, këst i ulët në krahasim me këstin e subjektit, pasi pjesën më të madhe të shumës, sipas subjektit, u është dhënë atyre.

**46.3.** Subjekti ka shpjeguar se për shkak se kishin prenotuar biletat për udhëtimin me target nga Durrësi drejt Italisë, i kishin lënë shtetasen S.Q prokurën e posaçme nr. \*\*\* datë 17.12.2020, për të tërhequr depozitën në shumën 67,000 USD.

**46.4.** Subjekti ka pretenduar se deklarimi në lidhje me maturimin e depozitës ka qenë pasaktësi dhe se Komisioni duhet të vlerësojë përdorimin e depozitës në dritën e të gjithë fakteve dhe rrethanave të ndodhura nga periudha dhjetor 2010 në shkurt 2011.

**46.5.** Subjekti ka pretenduar se shtetasit F e S.Q nuk janë persona të tjerë të lidhur, pasi huaja është dhënë dhe kthyer brenda pak orësh me nënshkrimin e prokurës për tërheqjen e shumës dhe se nuk ka pasur detyrimin të justifikojë ligjshmërinë e të ardhurave, në kuptim të nenit 32 pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

**46.6.** Të gjitha këto veprime, sipas subjektit, janë kryer brenda vitit 2010 dhe nuk ka asnjë ndryshim që kishte mbetur për t'u deklaruar në datë 31.12.2010, prandaj ka vlerësuar se nuk ka pasur detyrim të deklarojë këtë marrëdhënie në DIPP/2010.

**46.7.** Subjekti ka shpjeguar dhe paraqitur dokumentacion mbi mundësitë financiare të shtetasit F.Q si bashkortak në shoqërinë “\*\*\*\*” me objekt veprimtare shkëmbimin monetar, e cila ka një kapital të regjistruar në shumën 2, 500, 000 lekë. Nga analiza e llogarive bankare në dollarë në BKT për periudhën 2007 deri në vitin 2010 ka transaksione të konsiderueshme deri në 125, 000 dollarë apo 88, 000 euro. Bazuar në vërtetimin e lëshuar nga Bashkia Lushnjë për xhiron e subjektit “\*\*\*\*\*” sh.p.k., rezulton se ka pasur një xhiro rreth 1,300,000 lekë në vit. Marzhi i fitimit në këtë xhiro është i lartë, pasi kjo është vetëm e ardhur si rezultat i këmbimit valutor dhe ndryshimit të kursit të këmbimit në shitje dhe blerje.

**46.8.** Si përfundim, subjekti ka kërkuar që të përfshihet në analizën financiare shuma e paguar prej 25,000 eurosh për këstin e parë nga shtetasit Q si detyrim ndaj tij, si dhe pakësimi i gjendjes *cash* në shumën 1,000,000 lekë, pasi, sipas subjektit, bashkëshorti i saj ka përdorur gjendjen *cash* e ka këmbyer në euro dhe ka depozituar në datën 24 qershor 2010 shumën prej 7,400 eurosh, ku, referuar kursit të këmbimit të datës 24 qershor 2010, shuma prej 7,400 eurosh është ekuivalente në 1,012,838 lekë me kursin e këmbimit të kësaj date.

**46.9.** Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provave aktet: 1) kopje të lëvizjeve të llogarive të subjektit tregtar “\*\*\*\*\*” sh.p.k. në BKT dhe “Credins” për muajt shtator – dhjetor 2010; 2) deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 29.10.2011 të shtetasve F dhe S.Q; 3) vërtetim nga Bashkia Lushnjë për xhiron vjetore të deklaruar nga subjekti tregtar “\*\*\*\*” sh.p.k për vitet 2008-2013; 4) kontratë paraprake shitjeje pasurie e paluajtshme e datës 17.12.2010, të lidhur midis S.Q dhe “\*\*\*\*\*” sh.p.k, në të cilën përcaktohet kësti i parë në vlerën 13,000 euro; 5) kontratë shitjeje pasurie e paluajtshme e datës 25.2.2011, të lidhur midis S.Q e F.Q dhe “\*\*\*\*\*” sh.p.k, në të cilën përcaktohet se vlera e apartamentit prej 73,687 eurosh është likuiduar midis palëve; 6) mandatarkëtimi i datës 17.12.2010, në shumën 13,000 euro firmosur nga F.Q me përshkrimin “Likuidim pjesor për blerje apartamenti \*\*\*, godina \*\*\*, objekti S” dhe mandatarkëtimi në shumën 60,000 euro në datën 25.2.2011 në favor të shoqërisë së mësipërme.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**47.** Trupi gjykues, pasi shqyrtoi me objektivitet shpjegimet e subjektit dhe administroi provat shkresore, vlerëson se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës dhe se shpjegimet e subjektit mbeten në nivel deklarativ.

**47.1.** Subjekti nuk provoi deklarinin e saj në DIPP/2010 dhe në deklaratën “Vetting” për pagesën e këstit të parë prej 25,000 eurosh me depozitën bankare, pasi, nga hetimi i Komisionit rezultoi se në datën e pagesës, pra, në datën 17.12.2010 depozita rezultoi e patërhequr nga banka “Raiffeisen”.

**47.2.** Gjithashtu, subjekti nuk arriti të provojë deklarinin e bërë rishtazi gjatë procesit të hetimit administrativ në lidhje me pagesën e këtij kësti me të ardhurat e shtetasve Q, për sa nga hetimi rezultoi se subjekti nuk ka deklaruar në DIPP/2010 se burim krijimi për pagesën e këstit të parë kanë qenë të ardhurat e shtetasve Q.

**47.3.** Pretendimi i subjektit se për shkak se të gjitha veprimet janë kryer brenda vitit 2010 dhe nuk ka pasur detyrim të deklarojë në DIPP/2010 nuk qëndron dhe është i pabazuar në ligj. Ligji 9049/2003, “Për deklarinin e pasurive” në nenin 4 pika 1, germa “d” parashikon detyrimin e subjekteve të deklarojnë gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit përkatës të vlerës së likuiditeteve, gjendje në *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj. Në zbatim të kësaj dispozite, subjekti ka pasur detyrimin të deklarojë në DIPP/2010 se gjendja e depozitës disponohet nga shtetasit Q.

**47.4.** Trupi gjykues vlerëson se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në DIPP/2010 ku ka deklaruar se ka përdorur gjithë depozitën për blerjen e apartamentit, pasi nga hetimi rezultoi se depozita u tërhoq nga shtetasja S.Q në datën 21.12.2010 dhe nuk mund të ketë shërbyer për pagesën e kështit të parë prej 25,000 euro, kështu i cili nga hetimi u provua se është paguar me mandatpagesën e datës 17.12.2010 nga bashkëshorti i subjektit, z. A.Dh.

**47.5.** Subjekti nuk arriti të provojë gjithashtu të kundërtën e konstatimit të Komisionit mbi maturimin e depozitës që në datën 8.12.2010, për rrjedhojë depozita ishte e lirë të përdorej nga subjekti në datën e pagesës së kështit të parë.

**47.6.** Pretendimi i subjektit se kështi i parë është paguar nga shtetasit Q mbetet në nivel deklarativ, pasi nuk provohet se ky kështu të jetë paguar nga këta shtetas. Përkundrazi, mandatpagesa e datës 17.12.2010 mban emrin e bashkëshortit të subjektit.

**47.7.** Trupi gjykues i vlerëson jo bindëse shpjegimet e subjektit se shtetasit Q kanë paguar më pak nga kështi i tyre, duke qenë të disponueshëm për të paguar kështin e subjektit të rivlerësimit. Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, referuar kontratave të lidhura përkatësisht me shtetasit F dhe S.Q, si dhe mandatarkëtimit të datës 17.12.2010 rezulton se shtetasi F.Q ka paguar të plotë kështin e parë për blerjen e apartamentit të tij, aq sa ishte parashikuar në kontratën paraprake, në shumën 13,000 euro dhe nuk ka paguar më pak, siç ka shpjeguar subjekti i rivlerësimit.

**47.8.** Pretendimi i subjektit se shtetasit Q nuk janë persona të tjerë të lidhur në kuptim të ligjit nr. 84/2016, me arsyetimin se huaja është dhënë dhe kthyer brenda pak orësh, e për rrjedhojë nuk ka detyrimin të justifikojë ligjshmërinë e burimeve, është i pabazuar, pasi dispozita e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 nuk e ka kufizuar në kohë justifikimin e ligjshmërisë së të ardhurave të dhëna hua.

**47.9.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit për të ardhurat e shtetasit F.Q, konstatohet se ky shtetas ka themeluar shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k. bashkë me një ortak tjetër, T.Q, me objekt aktiviteti “shkëmbim valutor”, e cila ka realizuar aktivitet tregtar sipas xhiros vjetore të deklaruar pranë organit kompetent, por nuk provohet nëse shoqëria ka rezultuar me fitim dhe ky fitim të jetë shpërndarë në formë dividendi shtetasit F.Q në cilësinë e ortakut. Gjithashtu, llogaritë bankare të paraqitura nga subjekti nuk përfaqësojnë kapacitetet financiare të shtetasit Q, por tregojnë transaksione të ndryshme që ka kryer shoqëria në kuadër të ushtrimit të aktivitetit tregtar.

**47.10.** Në lidhje me analizën financiare të datës 17.12.2010, trupi gjykues vlerëson se nuk mund të përfshihet kundërvlera e shumës 25,000 euro në zërin detyrime të subjektit ndaj shtetasve Q, për sa subjekti nuk arriti të provojë se kështi i parë është paguar nga këto shtetas. Gjithashtu në analizën e kësaj date, nuk mund të përfshihet pakësimi i gjendjes *cash* në shumën 1,000,000 lekë, e cila, sipas subjektit, është përdorur nga bashkëshorti i saj për blerjen e automjetit “Benz”, të depozituar në datën 24 qershor 2010, në kundërvlerën e saj prej 7,400 eurosh. Nga hetimi ka rezultuar se në deklaratën e vitit 2010, subjekti nuk ka deklaruar blerjen e automjetit “Benz” dhe se shuma prej 1,000,000 lekësh, e referuar nga subjekti si burim për blerjen e këtij automjeti është shuma e deklaruar në DIPP/2009 si total i të ardhurave të përfituara nga shitja e një automjeti, tip “Benz” në shumën 500,000 lekë dhe kursimeve *cash* në shumën 500,000 lekë. Në analizën financiare të datës 17.12.2010 janë përfshirë dhe shpenzimet jetike për babain e subjektit, bazuar në deklaramin e saj se babai ka jetuar me subjektin deri para se të ndërronte jetë. Në përfundim të analizës, rezultati financiar ndryshon nga shuma -4,088,943 lekë në -4,225,563 lekë.

**47.11. Si konkluzion,** lidhur me pagesën e kështit të parë prej 25,000 eurosh në datën 17.12.2010, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në DIPP/2010 për pagesën e këtij kështi me burim nga depozita bankare në “Raiffeisen Bank” pasi nga hetimi rezultoi se subjekti nuk ka

përdorur depozitën si burim për pagesën e kështit të parë. Gjithashtu, subjekti ka rezultuar me mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën prej **-4,225,563 lekë** për të justifikuar pagesën e kështit të parë, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

## Tabela nr. 2

Analiza financiare përfundimtare për pagesën e kështit të parë prej 25,000 eurosh për blerjen e apartamentit

	<b>17.12.2010</b>
<b>A) PASURI</b>	<b>4,686,883</b>
Apartament në bashkëpronësi me bashkëshortin, me sipërfaqe totale 112.1 m2, me nr.pas. ***, ZK *** S, Tiranë, blerë në 15.2.2011.Pagesa e kështit 25,000 euro datë 17.12.2010.	3,470,250
Automjet Mercedes Benz ML me targa AA***DB (***), në bashkëpronësi me bashkëshortin. Vlera e autoveturës 9.000 euro	1,249,290
Ndryshim likuiditeti	-32,657
<b>B) DETYRIME</b>	<b>0</b>
<b>C) PASURI NETO (A-B)</b>	<b>4,686,883</b>
<b>D) TË ARDHURA</b>	<b>1,394,278</b>
Të ardhura nga paga e SR	959,114
Të ardhura nga fitimi bashkëshortit të SR (Person Fizik Stomatolog)	239,446
Të ardhura nga këmbimi valutor nga lekë në usd	195,718
<b>E) SHPENZIME</b>	<b>932,958</b>
Shpenzime jetese	683,100
Shpenzime udhëtimi TIMS	249,858
<b>Balanca e fondeve (D-C-E)</b>	<b>-4,225,563</b>

### Në lidhje me pagesën e kështit të dytë në shumën 20,000 eurosh

**48.** Në DIPP/2011, subjekti ka deklaruar “...kredi hipotekore e përdorur për blerjen e apartamentit si më sipër me afat 15 vjeçar nr \*\*\*, disbursuar në datën 09.03.2011 shuma 5,000,000 lekë.” Depozita bankare në Raiffeisen Bank, dega Lushnje është tërhequr dhe përdorur e gjitha për blerjen e një apartamenti të ndodhur në zonën kadastrale \*\*\*, nr. pasurie \*\*\*, F, Tiranë.

**48.1.** Gjatë hetimit të ILDKPKI-së, i është kërkuar subjektit të sqarojë në lidhje me mosdeklarimin në DIPP/2010 të likuiditetit të mbetur nga tërheqja e depozitës pranë “Raiffeisen Bank” në vitin 2010, e cila ka sqaruar<sup>68</sup> se: *Likuiditeti nuk është mbajtur cash, por ka shërbyer për likuidimin e një pjese të detyrimit dhe konkretisht 45,000 euro ndaj firmës së ndërtimit...*”.

**48.2.** Më tej, nga hetimi bankar<sup>69</sup> i Komisionit në lidhje me llogaritë e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, janë konstatuar këto fakte: i) në datën 11.2.2011, në llogarinë në euro pranë “Raiffeisen Bank” subjekti ka depozituar shumën prej 20,000 eurosh me përshkrimin “*Saemira Hila derdh ne llog te ardhura nga biznesi*”; 2) në datën 11.2.2011 shuma prej 20,000 eurosh është transferuar në favor të “\*\*\*”sh.p.k., me përshkrimin “*kalim për blerje apartamenti*”.

**48.3.** Në DIPP/2011 subjekti ka deklaruar se ka tërhequr të gjithë depozitën bankare në “Raiffeisen Bank” për ta përdorur për blerjen e apartamentit, ndërkohë nga hetimi ka rezultuar

<sup>68</sup> Shih përgjigjen e pyetjes nr \*\*\* të procesverbalit datë 29.4.2015, të mbajtur para ILDKPKI-së, dërguar me shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 18.6.2021.

<sup>69</sup> Shkresa nr. \*\*\* nga “Raiffeisen Bank”, prot., datë 12.3.2020, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 10.4.2020.

se depozita është tërhequr në vitin 2010 me prokurë nga shtetasja S.Q në datën 21.12.2021 dhe subjekti nuk ka deklaruar në këtë vit në lidhje me këtë fakt.

**48.4.** E pyetur<sup>70</sup> nga Komisioni në lidhje me këtë konstatim, si dhe burimin e krijimit për pagesën e shumës prej 20,000 euro, subjekti ka sqaruar se kjo shumë është pjesë e depozitës prej 67.000 USD në “Raiffeisen Bank”. Shuma është tërhequr sipas tagrave të prokurës nga znj. S.Q dhe është konvertuar në euro, duke qenë se familjarët Q ushtronin aktivitetin e këmbimit valutë dhe është mbajtur për arsye sigurie prej tyre dhe më pas është paguar prej subjektit nëpërmjet bankës në llogarinë e shoqërisë, për llogari të çmimit total të shitjes së apartamentit 82,500 euro.

**48.5.** Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provave për të provuar deklaratimet e saj, aktet: 1) kopje të ekstraktit tregtar të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., printuar nga faqja e QKB –së, lëshuar në datën 18.6.2021; 2) kopje të kontratës së huas me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 15.2.2011, sipas së cilës është përcaktuar se detyrimi i mbetur i papaguar ndaj shoqërisë shitëse është në shumën 37,500 euro, i cili do të paguhet me kredi bankare.

**48.6.** Nga analiza e dokumentacionit administruar gjatë hetimit dhe deklaratimit në DIPP/2011, konstatohet se subjekti nuk ka deklaruar pagesën e këstit të dytë në shumën prej 20,000 euro me burim nga të ardhurat e kthyer nga shtetasit Q, e për rrjedhojë Komisioni nuk i ka konsideruar këto të ardhura në analizën financiare.

**48.7.** Gjithashtu, nga analiza e kryer në koherencë e deklaratimeve të subjektit për vitin 2010 dhe 2011, si dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit, konstatohet mospërputhje e deklaratimit të subjektit në DIPP/2010 me rrethanat e faktit, si dhe me deklaratimin vijues të saj në DIPP/2011, në lidhje me përdorimin e burimeve për pagesën e kësteve të çmimit të blerjes, pasi subjekti ka deklaruar në DIPP/2010 se pjesa e mbetur e detyrimit ndaj shitësit pas pagesës së shumës 25,000 euro, do të shlyhet me kredi në shumën 57,500 euro, deklarim i cili nuk përputhet me rrethanat e faktit dhe as me deklaratimin të subjektit në DPV/2011 në lidhje me kredinë e marrë në shumën 5,000,000 lekë.

**48.8.** Për sa rezultoi nga hetimi dhe bazuar në dokumentacionin e administruar në dosjen e hetimit, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2011 – 11.2.2011, me qëllim verifikimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për kryerjen e pagesës së këstit të dytë në shumën 20,000 euro në datën 11.2.2011, në përfundim të së cilës subjekti rezultoi në pamjaftueshmëri financiare në shumën prej -2,767,827 lekësh për të paguar këstin e dytë.

**48.9.** Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit për sa rezultoi se: i) subjekti nuk ka deklaruar në DIPP/2011 pagesën e këstit të dytë në shumën prej 20,000 eurosh ndaj shoqërisë shitëse; ii) nga verifikimi i DIPP/2010, konstatohet se subjekti dhe personi i lidhur me të nuk kanë deklaruar gjendje *cash* nga depozita e tërhequr nga “Raiffeisen” deri në datën 31.12.2010 dhe as të dhëna në lidhje me administrimin e depozitës nga shtetasit Q, sikurse pretendohet nga subjekti dhe, për rrjedhojë nuk provohet se pagesa e këstit të dytë në shumën prej 20,000 eurosh në vitin 2011 të jetë kryer me burim nga depozita e “Raiffeisen Bank”; iii) nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesën e këstit të dytë në vlerën 20,000 euro në datë 11.2.2011, duke rezultuar me balancë negative në shumën prej -2,767,827 lekësh.

---

<sup>70</sup> Pyetësori nr. 2, pyetja nr. 2.

## **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**49.** Subjekti ka shpjeguar se pagesa e shumës tek shitësi i apartamentit është shtrirë përgjatë viteve 2010 dhe 2011, sikurse është deklaruar dhe në DIPP/2010 dhe 2011. Përdorimi i depozitës ka nisur në vitin 2010 dhe ka përfunduar në vitin 2011.

**49.1.** Subjekti ka pretenduar se mosdeklarimi shprehimisht i pagesës me dy këste, si edhe shumën e secilit këst, si edhe as veprimet me zotërinjtë F dhe S.Q, përbëjnë pasaktësi dhe se nuk ka pasur asnjë qëllim për fshehjen e veprimeve më sipër, të cilat janë lehtësisht të verifikueshme nga regjistrat e bankës; janë tërësisht të ligjshme, të moralshme dhe në mirëbesim të plotë mes palëve. Kjo pasaktësi sipas subjektit lidhet me faktin se “ipso facto” asnjëherë nuk e ka vlerësuar veten të lidhur në marrëdhënie huaje me këta shtetas, për sa kohë që subjekti dhe bashkëshorti i saj kishin burimet e tyre të ligjshme (depozitën) për pagesën e pjesës kryesore të çmimit të apartamentit në Tiranë. Subjekti ka shpjeguar se edhe në jurisprudencën e konsoliduar të trupave të rivlerësimit të KPA -së pranohet se gabimet e kryera nga subjektet në deklarime nuk përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore. Subjekti ka kërkuar që Komisioni të marrë në konsideratë shumën e mbetur të depozitës, pasi pavarësisht pasaktësive në deklarim, pagesa e kësteve është përballuar tërësisht me depozitën.

**49.2.** Deklarata “Vetting” dhe DIPP-të vjetore kanë pasaktësi ndërmjet tyre sipas subjektit, të cilat janë sqaruar tërësisht në “Vetting”. Subjekti ka shpjeguar se në DIPP/2011 ka deklaruar se ka paguar të gjithë shumën prej 82,500 euro dhe e gjithë depozita bankare në “Raiffeisen Bank” është përdorur për blerjen e apartamentit, duke përfshirë këtu edhe këstin prej 20,000 eurosh.

**49.3.** Subjekti ka kundërshtuar edhe mënyrën e ndërtimit të analizës, duke pretenduar se Komisioni nga njëra anë nxjerr balancë negative nga analiza financiare e datës 11.2.2011 dhe nga ana tjetër në analizën financiare për vitin 2010 nxjerr balancë pozitive + 3,006,522, pa përfshirë këtu edhe pakësimin e gjendjes *cash* prej 1,000,000 lekësh për blerjen e automjetit.

## **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**50.** Trupi gjykues, pasi shqyrtoi me objektivitet shpjegimet e subjektit, vlerëson se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës për arsyet si vijon:

**50.1.** Nga analiza e shpjegimeve të subjektit duket qartë që subjekti pranon mosdeklarimin në DIPP/2010 dhe 2011 të pagesës së 2 kësteve dhe të veprimeve të kryera me shtetasit F dhe S.Q, por se ky mosdeklarim, në vlerësim të trupit gjykues, nuk mund të mbetet në nivel pasaktësie, për sa lidhet drejtpërdrejt me identifikimin e burimeve që kanë shërbyer për pagesën e këstit të parë dhe të dytë të çmimit të blerjes së apartamentit.

**50.2.** Subjekti nuk arriti të provojë se kësti i dytë është paguar me të ardhurat nga tërheqja e depozitës së deklaruar në DIPP/2010 dhe 2011, për sa nuk rezultoi të ketë deklaruar në DIPP 2010 në lidhje me gjendjen e mbetur të depozitës pas pagesës së këstit të parë në shumën prej 25,000 eurosh dhe as destinimin e shumës së depozitës në favor të shtetasve Q, në zbatim të detyrimit ligjor përcaktuar në nenin 4, pika 1, germa “d” të ligjit nr. 9049/2003, sipas të cilit subjektet deklaruese detyrohen të deklarojnë gjendjen deri në 31 dhjetor të vitit përkatës të vlerës së likuiditeteve, gjendje në *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj, si dhe burimin e krijimit të tyre.

**50.3.** Duke i dhënë vlerë provuese deklarimit vjetor, në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk arriti të provonte shlyerjen e pagesës së këstit të dytë në shumën prej 20,000 me të ardhurat nga depozita pranë “Raiffeisen Bank”, për sa nuk ka deklaruar në DIPP/2011 shlyerjen e këtij kësti me burim nga pakësimi i gjendjes së depozitës deklaruar një vit më parë.



**50.4.** Në lidhje me analizën financiare të datës 11.2.2011, pas shqyrtimit të kundërshtimeve të subjektit, trupi gjykues çmon se analiza është përgatitur mbi bazën e dokumentacionit të marrë në rrugë zyrtare, sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, duke vlerësuar të dhënat e rezultuara nga hetimi në raport me deklaratimet e subjektit në ILDKPKI dhe gjatë hetimit administrativ, si dhe me provat e paraqitura nga subjekti.

**50.5.** Trupi gjykues vlerëson se analiza financiare duhet të ndryshojë vetëm tek zëri “shpenzime jetese”, ku të përfshihen dhe shpenzimet jetike për babain e subjektit për këtë periudhë, bazuar në deklarinimin e subjektit se babai ka jetuar me të deri para se të ndërronte jetë. Në përfundim të analizës, rezultati financiar ndryshon nga shuma -2,767,827 lekë në shumën -2,783,173 lekë.

**50.6. Si konkluzion,** në lidhje me pagesën e kështit të dytë në shumën prej 20,000 eurosh në datën 11.2.2011, subjekti ka kryer deklarinim të pasaktë në DIPP/2011, në lidhje me burimin “depozitë bankare” në “Raiffeisen Bank” për blerjen e apartamentit, pasi nga hetimi rezultoi se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën e një viti më parë gjendje të kësaj depozite të tërhequr në vitin 2010, e cila mund të përbente burim krijimi për pagesën e kështit të dytë në datën 11.2.2011. Gjithashtu, subjekti ka rezultuar me mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën prej **-2,783,173 lekësh** për të justifikuar pagesën e kështit të dytë, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

### Tabela nr. 3

Analiza financiare përfundimtare për pagesën e kështit të dytë prej 20,000 eurosh për blerjen e apartamentit

	<b>11.02.2011</b>
<b>A) PASURI</b>	<b>89 111</b>
Ndryshim likuiditeti	89 111
<b>B) DETYRIME</b>	<b>0</b>
<b>C) PASURI NETO (A-B)</b>	<b>89 111</b>
<b>D) TË ARDHURA</b>	<b>172 869</b>
Të ardhura nga paga e SR	143 280
Të ardhura nga fitimi bashkëshortit të SR (Person Fizik Stomatolog)	29 589
<b>E) SHPENZIME</b>	<b>2 866 932</b>
Shpenzime jetese	76 732
Shpenzime për pagesë kështi për blerjen e apartamentit në Tiranë (20,000 euro)	2 776 200
Shpenzime për arsimin e fëmijëve	14 000
<b>Balanca e fondeve (D-C-E)</b>	<b>-2 783 173</b>

### Në lidhje me pagesën e kështit të tretë në shumën 37,500 euro

**51.** Në lidhje me pagesën e kështit të tretë me kredi bankare, bazuar në deklaratimet e subjektit dhe dokumentacionin bankar të dërguar nga Raiffeisen Bank<sup>71</sup>, është konfirmuar marrja e kësaj kredie në shumën rreth 5,000,000 lekë dhe përdorimi i saj për shlyerjen e kështit të tretë të apartamentit në datën 10.03.2011, në vlerën prej rreth 37,500 euro. Trupi gjykues nuk ka konstatuar problematika në lidhje me pagesën e kështit të tretë.

**52. Pasuria e llojit “autoveturë”,** marka “Mercedes-Benz - Daimler Chrysler”, “ML \*\*\*”, viti i prodhimit 2003, me targa italiane në momentin e blerjes CK \*\*\* JA, me targa shqiptare

<sup>71</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 12.3.2020, e “Raiffeisen Bank”, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 10.4.2020.

AA \*\*\* DB, në bashkëpronësi me bashkëshortin A.Ll.Dh, blerë nga bashkëshorti në Itali. Vlera e automjetit **9.000 euro**.

**52.1. Burimi i krijimit:** me kursimet e tyre të viteve të mëparshme, si edhe nga fitimi i realizuar nga shitja në shumën 500.000 lekë e automjetit të parë me targa LU \*\*\* B.

### **Deklarimi i pasurisë ndër vite**

**53.** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP/2012 pasurinë e mësipërme, me çmim blerjeje 10,500 euro, blerë nga bashkëshorti në Itali, me kursimet e përbashkëta të viteve të mëparshme.

### **Hetimi/verifikimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri**

**54.** Nga hetimi i Komisionit<sup>72</sup>, janë konstatuar faktet si vijojnë:

**54.1.** Në datën 24.6.2010, bashkëshorti i subjektit ka transferuar në favor të A.Dh shumën prej 7,400 eurosh.

**54.2.** Në datën 5.7.2010, është blerë automjeti tip “ML \*\*\* CDI”, kundrejt çmimit 9,000 euro.

**54.3.** Në datën 11.7.2010, ky automjet ka hyrë në territorin shqiptar, ku në vijim, në datën 22.2.2012, është paguar zhdoganimi i mjetit në vlerën prej 194,507 lekësh nga bashkëshorti i subjektit. Duket se vlera prej 10,500 eurosh e deklaruar nga subjekti në DIPP/2012 për automjetin objekt vlerësimi, ka përfshirë çmimin e blerjes prej 9,000 euro dhe pagesën e zhdoganimit prej 194,507 lekë.

**54.4.** Në datën 21.3.2012 është lëshuar certifikata e pronësisë së mjetit në emër të bashkëshortit të subjektit dhe në vijim në datën 30.3.2012, bashkëshorti i subjektit ka lëshuar një deklaratë noteriale, ku ka dhënë pëlqimin që automjeti të regjistrohet në bashkëpronësi me subjektin e rivlerësimit.

**54.5.** Në datën 2.4.2012, është lëshuar certifikata e pronësisë së mjetit, në emër të A.Dh dhe Saemira Hila.

**54.6.** Subjekti ka sqaruar gjatë hetimit administrativ se<sup>73</sup> është bashkëpronare me bashkëshortin në pasurinë e mësipërme. Në dijeni e saj ky automjet është blerë *cash* në shumën 9000 euro në Itali, nga kunati i saj A.Dh. Për këtë qëllim bashkëshorti i ka kaluar nëpërmjet transfertës bankare shumën 7400 euro, ndërsa pjesa tjetër është plotësuar më vonë, për shkak të lidhjes familjare. Veprimet për automjetin janë kryer nga vëllërit e bashkëshortit A.Dh dhe E.Dh.

### **Në lidhje me burimin e krijimit**

**55.** Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar si burime krijimi kursimet e viteve të mëparshme, si edhe të ardhura nga fitimi i realizuar nga shitja në shumën 500.000 lekë e automjetit të parë me targa LU \*\*\* B.

## **I. Në lidhje me burimin “kursime të viteve të mëparshme”**

**55.1.** Për vlerësimin e këtij burimi, Komisioni u është referuar deklarimeve të subjektit në deklaratat periodike, ku deri në vitin 2008 subjekti nuk ka deklaruar asnjëherë kursime, ndërsa

<sup>72</sup> Shkresa e DPSHTRR-së nr. \*\*\* prot., datë 3.8.2017 në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresa nr \*\*\* datë 1.4.2020 e DPSHTRR-së; shkresa kthim përgjigjeje e ILDKPKI-së nr. \*\*\* prot., datë 28.6.2021 dhe shkresa kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 12.3.2020 nga “Raiffeisen Bank”.

<sup>73</sup> Pjesë nga përgjigjet e pyetjes nr. 7, të pyetësorit nr. 1.

në DIPP/2009 subjekti ka deklaruar: “...500,000 lekë, kursime në formën e shumës cash të cilat i kemi në shtëpi dhe i përdorim për nevoja familjare...”.

**55.2.** Por, në DIPP/2010, që i referohet vitit kur është blerë automjeti, subjekti nuk ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash* të kursimeve të deklaruara më parë dhe për rrjedhojë kursimet e akumuluarra deri në 31.12.2009 nuk mund të kenë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie në vitin 2010.

## **II. Në lidhje me burimin “të ardhura nga shitja e automjetit në shumën 500.000 lekë”**

**55.3.** Në DIPP/2009 subjekti ka deklaruar “...Të ardhura të përfituara nga shitja e automjetit të regjistruar në bashkëpronësinë time dhe të bashkëshortit tip Mercedes Benz shuma 500,000 lekë...”.

**55.4.** Nga analizimi në koherencë me njëra-tjetrën të deklarimeve të subjektit në DIPP/2009, rezulton se të ardhurat e deklaruara në këtë vit nga shitja e automjetit prej 500,000 lekësh kanë shërbyer për krijimin e kursimeve të deklaruara në këtë vit në të njëjtën shumë, e për rrjedhojë nuk duket të kenë shërbyer si burim krijimi për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi, për sa subjekti nuk ka deklaruar në DIPP/2010 për blerjen e automjetit me burim krijimi të ardhurat nga shitja e automjetit në shumën 500.000 lekë.

**55.5.** Nga kjo analizë rezulton se asnjëri nga burimet e deklaruara nga subjekti në deklaratën “Vetting”, s’ka shërbyer për pagesën e çmimit të automjetit në vlerën prej 9,000 eurosh në datën 5.7.2010.

**55.6.** Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1.1.2010 – 5.7.2010 për mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të për të paguar shumën 9,000 euro në datën 5.7.2010, nga ku rezultoi me pamjaftueshmëri financiare në shumën prej - 1,164,969 lekë.

**55.7.** Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit për sa rezultoi se: 1) subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë deklaruar në DIPP/2010 krijimin e kësaj pasurie dhe për rrjedhojë as burimet e krijimit të saj; 2) nuk përputhet deklarimi i subjektit DIPP/2012 me atë “Vetting” në lidhje me burimet e krijimit, pasi në DIPP/2012 subjekti ka deklaruar si burim kursimet e viteve të mëparshme, ndërsa në “Vetting” ka shtuar si burim edhe fitimin e realizuar nga shitja e automjetit të parë në shumën 500.000 lekë; 3) nga analiza financiare e kryer nga Komisioni rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesën e çmimit të automjetit në datën 5.7.2010, duke rezultuar me balancë negative në shumën -1,164,969 lekë.

## **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**56.** Subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se, pavarësisht pasaktësive në deklaratimet e vitit 2010 dhe 2012, ka deklaruar saktësisht gjatë hetimit administrativ në përgjigje të pyetësorit standard se pagesa prej 7,400 eurosh me përfitues shtetasin A.Dh ka qenë pikërisht për blerjen e automjetit. Derdhja në shumën 7,400 euro ka qenë pikërisht nga gjendja *cash* e disponuar nga një vit më parë, të cilën Komisioni nuk e ka përfshirë si burim krijimi. Subjekti ka shpjeguar se shtimi i gjendjes *cash*, të deklaruar në 2009 nga shitja e automjetit është përdorur për blerjen e automjetit të ri, duke mbajtur parasysh që ka qenë pikërisht *cash*-i i deklaruar në fund të vitit 2009, që ka shërbyer si burim krijimi për blerjen e automjetit tip “Mercedes Benz ML”.

**56.1.** Në lidhje me mospërputhjen e deklarimeve të subjektit në DIPP/2012 me atë “Vetting” për burimet e krijimit, subjekti ka shpjeguar se DIPP/2012 ka deklaruar si burim kursimet e viteve të mëparshme për blerjen e automjetit, ndërsa në “Vetting” ka shtuar si burim edhe fitimin e realizuar nga shitja e automjetit të parë në shumën 500,000 lekë. Si burim është i

njëjtë, kursimet nga gjendja *cash* dhe nga depozita janë pikërisht burimet e krjimit. Pavarësisht se duket sikur janë përdorur dy burime të ndryshme, në fakt është i njëjti burim, pasi shitja e automjetit ka shtuar gjendjen *cash* në fund të vitit 2009, që ka shërbyer si burim krjimi për blerjen e automjetit në vitin 2010.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**57.** Trupi gjykues, pas administrimit të shpjegimeve të subjektit mbi rezultatet e hetimit, vlerëson se ato nuk janë bindëse dhe se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e tyre. Subjekti nuk shpjegoi arsyet mbi mosdeklarimin e blerjes së automjetit në DIPP/2010. Interpretimi i subjektit mbi deklaratat në DIPP/2012 dhe “Vetting” për sa i përket burimit që ka shërbyer për blerjen e pasurisë automjet, nuk është i bazuar, për sa automjeti është blerë në vitin 2010 dhe subjekti nuk e ka deklaruar në këtë deklaratë shtimin e kësaj pasurie. Për rrjedhojë, burimet e pretenduara nga subjekti të përdorura për blerjen e automjetit, nuk duhet të konsiderohen në analizën financiare.

**57.1.** Trupi gjykues, në këtë analizë faktesh, ka parasysh dispozitat ligjore të ligjit nr. 84/2016 në lidhje me vlerësimin e pasurive të subjekteve të rivlerësimit, ku bazuar në nenin 30 të këtij ligji objekt i vlerësimit është deklarimi dhe kontrolli i pasurive për subjektin dhe personat e lidhur me të. Subjekti ka pasur detyrimin e deklarimit të shtimit të kësaj pasurie në vitin e krijimit të saj, pra, në vitin 2010, bazuar në nenin 3 dhe 4, pika 1, germa “b” të ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive”, i ndryshuar.

**57.2.** Nga analiza e fakteve të rezultuara nga hetimi dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e konstatimeve të Komisionit. Në analizën përfundimtare për blerjen e automjetit, janë rivlerësuar shpenzimet jetike, duke përfshirë në këtë zë edhe shpenzimet për babain e subjektit, bazuar në deklarimin e subjektit se babai ka jetuar me të deri para se të ndërronte jetë dhe për rrjedhojë rezultati financiar nga shuma -1,164,969 lekë arrin në shumën -1 233 279 lekë.

**57.3. Si përfundim,** në lidhje me vlerësimin e pasurisë autoveturë, marka “Mercedes – Benz, ML \*\*\*”, subjekti nuk ka kryer deklarimin e kësaj pasurie në DIPP/2010 në përputhje me ligjin nr. 9049/2003, si dhe ka rezultuar me mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën prej **-1 233 279 lekësh** për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie në datën 5.7.2010, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b” të ligjit nr. 84/2016.

#### **Tabela nr. 4**

Analiza financiare për blerjen e automjetit “Mercedes- Benz, ML”

	<b>05.07.2010</b>
<b>A) PASURI</b>	<b>1,510,245</b>
Automjet Mercedes Benz ML me targa *** (***), në bashkëpronësi me bashkëshortin. Dt 05.07.2010 Vlera e autoveturës 9.000 euro	1,249,290
Ndryshim likuiditeti	260,955
<b>B) DETYRIME</b>	<b>0</b>
<b>C) PASURI NETO (A-B)</b>	<b>1,510,245</b>
<b>D) TË ARDHURA</b>	<b>868,374</b>
Të ardhura nga paga e SR	531,492
Të ardhura nga fitimi bashkëshortit të SR (Person Fizik Stomatolog)	119,723
Të ardhura nga interesat e depozitës në Raiffeisen Bank	21,441
Të ardhura nga këmbimi valutator	195,718
<b>E) SHPENZIME</b>	<b>591,408</b>
Shpenzime jetese	341,550
<b>Balanca e fondeve (D-C-E)</b>	<b>-1,233,279</b>

**58. Pasuri e llojit depozitë** me afat në “Raiffeisen Bank” përkatësisht, shuma 536,597 lekë në emër të M.Dh dhe 536,597 lekë në emër të S.Dh.

**58.1. Si burim krijimi** të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar: *“dhuruar nga i ndjeri babai im J.H, nga kursimet e tij cash dhe depozitë në Raiffeisen Bank, shuma fillestare e të dy depozitave nga 450,000 lekë secila dhe shtuar vetëm nga interesat vjetore bankare”*.

#### **Deklarimi i kësaj pasurie në vite**

**58.2.** Në DIPP/2012 subjekti ka deklaruar për herë të parë në lidhje me pasurinë “depozitë”, dy depozita me afat nga **450,000 lekë secila**, të dhuruara nga i ndjeri, baba i saj, J.H, nga kursimet e tij cash, të cilat pas vdekjes së tij dhe me vullnetin e shprehur verbalisht para subjektit, i ka depozituar në “Raiffeisen Bank” në emër të vajzave M.A.Dh dhe S.A.Dh, në datën 30.3.2012.

**58.3.** Në deklaratat vijuese, DIPP 2013, 2014, 2015, 2016, subjekti ka deklaruar interesat vjetore të përfituara.

#### **Hetimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri**

**59.** Me vendimin nr. \*\*\* datë 21.12.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë<sup>74</sup> është lëshuar dëshmia e trashëgimisë për babain e subjektit, të ndjerin J.H.

**59.1** “Raiffeisen Bank”<sup>75</sup> konfirmon së në llogari të personave të lidhur M.Dh dhe S.Dh, në datën 30.3.2012, janë depozituar përkatësisht nga 450,000 lekë nga personi i lidhur A.Dh me përshkrimin *“derdh në llogari”* dhe në çdo vit është shtuar vetëm interesi bankar i depozitave. Nuk rezultojnë kreditime të tjera në llogari të kryera nga subjekti, personi i lidhur apo persona të tretë. Gjendja e depozitave përkatëse për secilën vajzë të subjektit në datën 31.12.2016 ka qenë 537,859 lekë.

**59.2.** Nga hetimi rezultoi se përputhet deklarimi i subjektit në deklaratën “Vetting” me të dhënat rezultuar nga hetimi administrativ.

#### **Analiza e burimeve të krijimit të kësaj pasurie**

**60.** Referuar deklaramit të parë për krijimin e depozitave, shuma e deklaruar nga subjekti si e dhuruar nga i ati ka qenë në total 900,000 lekë, ndërkohë nga hetimi është konstatuar se subjekti ka deklaruar para ILDKPKI-së në datën 29.4.2015 se në banesë babai ka pasur rreth 800,000 lekë të kursyera ndër vite dhe la amanet që këtë likuiditet subjekti ta depozitonte në emër të vajzave. Për këtë konstatim Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime në rezultatet e dërguara.

**60.1.** Më tej, duke konsideruar provë deklarimin e subjektit në DIPP/2012, bazuar në nenin 32 pika 5 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni analizoi dokumentacionin e administruar gjatë hetimit në lidhje me mundësitë financiare të babait të subjektit për të dhuruar shumën 900,000 lekë për vajzat e saj, ku me të ardhurat e përfituara nga pensioni<sup>76</sup> në shumën 1,100,000 lekë për periudhën tetor 2004 - dhjetor 2011, pa llogaritur të paktën shpenzimet minimale jetike për një person, të cilat për periudhën e referuar arrijnë rreth 925,000 lekë, rezulton se babai i subjektit gjendej në pamjaftueshmëri për të disponuar shumën prej 900,000 lekësh për vajzat e subjektit.

**60.2.** Për rrjedhojë, Komisioni përgatiti analizën financiare për mundësitë e subjektit dhe personit të lidhur me të për të investuar në depozita në total në shumën 900,000 lekë për vajzat

<sup>74</sup> Vendim nr. \*\*\*, datë 21.12.2012 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë në dosjen e ILDKPKI-së, aneksi \*\*\*.

<sup>75</sup> Shkresat nr. \*\*\*, prot., datë 12.3.2020; shkresa nr. \*\*\* prot., datë 12.7.2021, shkresa nr. \*\*\* prot., datë 15.7.2021, të “Raiffeisen Bank”.

<sup>76</sup> Vërtetim nga ISSH-ja, nr. \*\*\* prot., datë 31.10.2016, dosja e ILDKPKI-së.

e tyre në datën 30.03.2012, nga ku rezultoi pamjaftueshmëri financiare në shumën -1,061,882 lekë.

**60.3.** Bazuar në këto konstatime, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën në lidhje me rezultatin financiar negativ në shumën prej -1,061,882 lekë për të përballuar investimin në depozita, si dhe bazuar në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, subjekti ka detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit shumës së dhuruar *cash* nga babai i saj, i ndjeri J. H.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**61.** Subjekti ka shpjeguar se ka jetuar me babain e saj dhe ka përballuar shpenzimet e tij prej vitit 2005 deri në vitin 2012. Ajo ka sqaruar se prindërit e saj kanë pasur depozita pranë Bankës së Kursimeve dhe se babai ka pasur mundësi financiare të ketë gjendje shumën 800,000 lekë. Subjekti ka shpjeguar se, nëse analizohet mundësia për kursim deri në fund të vitit 2003, si dhe kontributi efektiv për dy depozitat në emër të nënës dhe të babait të saj, përkatësisht 1,066,362 lekë dhe 619,265.92 lekë dhe përlllogaritur edhe vlera 450,000 lekë për shtesën, rezulton se familja ka pasur mundësi të krijojë këtë gjendje likuiditeti në bankë dhe për të pasur kursime *cash*. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës lëvizje llogarie depozite “Raiffeisen Bank” për të ndjerin J.H.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**62.** Trupi gjykues, çmon se, duke konsideruar shpjegimet e subjektit se ka bashkëjetuar me babain e saj dhe i ka mbuluar atij shpenzimet jetike dhe nga ana tjetër, duke vlerësuar të ardhurat nga pensioni të përfituara nga babai i saj, ka pasur mundësi për krijimin e kursimeve të mundshme, të cilat janë bërë burim krijimi të depozitave të vajzave të subjektit.

**63. Pasuria e llojit “gjendje në llogari”** në “Intesa San Paolo Bank”, në shumën 205,056 lekë, në llogarinë e hapur në datën 6.5.2015, me qëllim studimet e vajzës M.Dh dhe në shumën 206,048 lekë në llogarinë e hapur në datën 12.3.2015, me qëllim studimet e vajzës S.Dh. Deklaron se zotëron ½ pjesë mbi këto pasuri.

**63.1. Si burim krijimi** të kësaj pasurie ka deklaruar: nga kalimi i vlerave periodike në shumën 10,000 lekë/muaj nga llogaria e pagës së subjektit.

### **Deklarimi i kësaj pasurie në vite**

**63.2.** Në DIPP/2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka dy depozita në “Intesa San Paolo Bank” në emër të fëmijëve të saj të mitur, M.A.Dh dhe S.A.Dh. Në këto dy llogari kalon nga llogaria e pagës së subjektit respektivisht për secilën që prej datës 6.5.2015 shuma prej 10,000 lekësh.

**63.3.** Në DIPP/2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në llogaritë e fëmijëve të mitur si më sipër, kalojnë respektivisht për secilën shuma prej 10,000 lekësh, së bashku me interesat bankarë që prej datës 6.5.2015. Shuma 120,000 lekë në secilën llogari.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni për këto pasuri**

**63.4.** Nga hetimi bankar<sup>77</sup>, “Intesa San Paolo Bank” konfirmon hapjen e llogarive respektive për vajzat e subjektit në datën 6.5.2015.

**63.5.** Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarive konstatohet se subjekti ka deklaruar saktë në përputhje me ligjin gjendjen e llogarive dhe burimin e krijimit të shumave të depozituara, si dhe nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur

<sup>77</sup> Shkresa kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 10.3.2020 nga “Intesa San Paolo Bank” sh.a.

me të kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar krijimin e pasurisë likuiditete bankare për vajzat M.Dh dhe S.Dh.

#### **64. Në lidhje me gjendjen *cash* deklaruar nga subjekti**

**64.1.** Nga verifikimi i deklarimeve ndër vite, konstatohet se subjekti deklaroi për herë të parë gjendje *cash* në DIPP/2009 si dhe në disa deklarata periodike të viteve pasuese, përkatësisht:

-Në DIPP/2009: “...500,000 lekë Kursime në formën e shumës *cash* të cilat i kemi në shtëpi dhe i përdorim për nevoja familjare...”.

-Në DIPP/2010: “...500,000 lekë shuma e kursyer gjatë një viti nga të ardhurat e siguruar nga puna e bashkëshortit dhe e imja...”.

-Në DIPP/2011: “...500,000 lekë shuma e kursyer gjatë një viti nga të ardhurat e siguruar nga puna e bashkëshortit dhe e imja...”.

-Në DIPP/2013 nuk ka deklarim për shtesa ose pakësime *cash*, por në deklarimin e kryer pranë ILDKPKI<sup>78</sup>-së subjekti ka deklaruar se gjendja e *cash*-it në fund të vitit 2013 ka qenë 1,000,000 lekë.

-Në DIPP/2014: “...300,000 lekë. Kursime në *cash* nga të ardhurat e siguruar nga paga ime dhe aktiviteti si dentist i bashkëshortit...”.

-Në DIPP/2015: “...a)Të gjitha kursimet *cash* ndër vite në total prej 10,000 euro ia kemi dhënë hua kunatit E.Dh, me adresë via \*\*\*, nr \*\*\*, V, V, Itali; b)Shuma 400,000 lekë kursime në *cash* nga të ardhurat e siguruar nga ushtrimi i aktivitetit privat "dentist" dhe nga paga e bashkëshortes...”.

-Në DIPP/2016: “...300,000 lekë kursime në *cash* nga të ardhurat e siguruar nga paga ime si gjyqtare dhe aktiviteti i bashkëshortit si stomatolog...”.

**64.2.** Bazuar në deklaratat e subjektit ndër vite, rezulton se nga verifikimi i ecurisë së gjendjes *cash*, gjendja e likuiditeteve në fund të vitit 31.12.2016 është në vlerën prej 700,000 lekësh, ndërsa në deklaratën “Vetting” datë 27.1.2017 subjekti ka deklaruar vlerën zero.

#### **Lidhur me burimin e krijimit**

**64.3.** Subjekti dhe personi i lidhur me të kanë deklaruar se këto fonde *cash* janë me burim nga paga dhe të ardhurat e krijuara nga vetëpunësimi si stomatolog.

**64.4.** Nga analiza financiare e kryer për mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të për të kursyer shumat e deklaruara në formën *cash* në vitet 2009,2010,2011,2013,2014,2015 dhe 2016, rezulton se ata nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin e gjendjes së likuiditeteve *cash* në vitin 2011 në shumën prej 500,000 lekësh dhe krijimin e gjendjes së likuiditeteve *cash* në vitin 2014 në shumën prej 300,000 lekë dhe për të përballuar investimet/shpenzimet e tjera të deklaruara/konstatuara nga Komisioni, duke rezultuar me pamundësi financiare përkatësisht, në shumën - 3,864,191 lekë në vitin 2011 dhe në shumën - 175,865 lekë në vitin 2014.

**64.5.** Gjithashtu, nga analiza e deklarimeve vjetore mbi gjendjen *cash* të deklaruar në raport me deklarimin në deklaratën “Vetting”, rezulton se subjekti ka patur likuiditete *cash* të deklaruara në datën 31.12.2016 në total në shumën 700,000 lekë, të cilat nuk janë deklaruar si

---

<sup>78</sup> Procesverbali i datës 15.4.2015 në ILDKPKI, pyetja nr.\*\*\*, në shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 18.6.2021 nga ILDKPKI.

gjendje *cash* në deklaratën “Vetting” datë 27.1.2017 dhe nuk është deklaruar as destinacioni i përdorimit të tyre.

**64.6.** Mbi bazën e këtyre konstatimeve, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e tyre, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**65.** Subjekti paraqiti shpjegimet e saj, duke u ndalur në secilin vit ku ka deklaruar gjendjen *cash*. Për vitin 2009, subjekti ka shpjeguar se deklarimi i saj ka pasaktësi, duke pretenduar të përfshihet në gjendjen *cash* në fund të vitit 2009, jo vetëm shuma prej 500,000 lekë e deklaruar shprehimisht, por edhe të ardhurat nga shitja e automjetit në vlerën 500,000 lekë, pra, në total prej 1,000,000 lekësh.

**65.1.** Për vitin 2010, subjekti ka pretenduar se duhet të përfshihet edhe gjendja e mbetur e depozitës pas pagesës së kështit prej 20,000 euro, të disponuar nga familja Q, pra—shuma prej 25,600 euro si diferencë e shumës 50,600 euro (ekuivalenti i depozitës në dollarë), si dhe 500,000 lekë nga kursimet e vitit 2010, pasi në vitin 2010 gjendja e *cash*-it është pakësuar edhe me vlerën 1,000,000 lekë, që përbënte të gjithë gjendjen *cash* në fund të vitit 2009 e përdorur si burim krijimi për blerjen e automjetit.

**65.2.** Për vitin 2011, gjendja e *cash*-it në fund të vitit përbëhet nga kursimi 500,000 lekë mbetur gjendje nga viti 2010, pasi në vitin 2011 e gjithë vlera e mbetur e depozitës u përdor për blerjen e apartamentit dhe pagimin e kredisë, si dhe 500,000 lekë shtesë, shumë kjo e deklaruar në DPV-në e vitit 2011 me përshkrimin “500,000 lekë shuma e kursyer gjatë një viti nga të ardhurat e siguruara nga puna e bashkëshortit dhe e imja”. Në total, gjendja *cash* në fund të vitit 2011 është 1,000,000 lekë. Për vitet 2012 dhe 2013 nuk ka ndryshim të gjendjes *cash*. Në vitin 2014 deklaroi shtesë 300,000 lekë.

**65.3.** Në lidhje me diferencën e gjendjes së DIPP/2016 me deklaratën “Vetting”, subjekti edhe për këtë konstatim ka shpjeguar se ka pasaktësi në plotësimin e dy deklaratave DIPP/2015 dhe 2016, pasi në DIPP/2015 dhe 2016 nuk ka deklaruar me shtesat çdo vit, por ka deklaruar gjendje *cash* në fund të vitit 2015 dhe në fund të vitit 2016. Gjendja në *cash* në fund të vitit 2016 është 300,000 lekë e cila është përdorur në fillim të vitit 2017, për blerjen e dy kompjuterave lap-top në shumën prej 300,000 lekësh.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**66.** Trupi gjykues në lidhje me gjendjen *cash*, vlerëson se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e pamjaftueshmërisë për krijimin e gjendjes *cash* për vitin 2011 dhe 2014 për arsyet si vijon:

**66.1.** Në lidhje me pretendimin se për vitin 2009 gjendja *cash* nuk është 500,000 lekë, sa deklaruar shprehimisht në DIPP/2009, por 1,000,000 lekë, duke përfshirë dhe të ardhurat nga shitja e automjetit në vlerën 500,000 lekë, ky pretendim është i pabazuar, pasi, referuar nenit 4, pika 1 të ligjit nr. 9049/2003, subjektet kanë pasur detyrimin të deklarojnë gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës, të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme. Në interpretim të kësaj dispozite ligjore, subjekti ka deklaruar gjendjen deri në 31.12.2009 për pasurinë “automjet”, tip “Mercedes –Benz” dhe kursime në formën e gjendjes *cash* në shumën 500,000 lekë nga të ardhurat e përfituara përgjatë vitit 2009. Për rrjedhojë, nëse subjekti pretendon se ka patur gjendje *cash* në fund të vitit 2009 shumën 1,000,000 lekë, duhet ta kishte deklaruar, në zbatim të nenit 4, pika 1, germa “d” e ligjit nr. 9049/2003.

**66.2.** Në lidhje me përfshirjen për vitin 2010 të të ardhurave të mbetura në shumën prej 25,600 eurosh të depozitës në “Raiffeisen Bank” nga pagesa e kështit të parë prej 20,000 eurosh, ky pretendim nuk është i bazuar, pasi, sikurse është trajtuar gjerësisht në seksionin e pagesës së



këstit të parë të apartamentit, subjekti nuk ka deklaruar në DIPP/2010 gjendje në fund të vitit 2010 nga disponimi i depozitës në “Raiffeisen Bank”. Ky pretendim bie në kundërshtim edhe me vetë deklaramet e saj, pasi subjekti ka shpjeguar se shuma e mbetur nga depozita është përdorur për qëllime të aktivitetit tregtar të shtetasit F.Q deri përpara kthimit nga Italia të subjektit dhe familjes së saj.

**66.3.** Edhe për vitin 2011, pretendimi i subjektit se mbi shtesën e deklaruar për këtë vit në shumën 500,000 lekë duhet të përfshihet edhe gjendja *cash* e mbetur nga viti 2010, është i pabazuar për të njëjtën arsye mosdeklarimi, pasi referuar DIPP/2011 subjekti ka deklaruar kursime vetëm në shumën 500,000 lekë.

**66.4.** Në lidhje me diferencën e gjendjes në DIPP/2016 me deklaratën “Vetting”, subjekti ka shpjeguar se ka pasur pasaktësi në plotësimin e DIPP/2015 dhe 2016, pasi ka deklaruar përkatësisht gjendje *cash* në fund të vitit dhe jo shtesë. Trupi gjykues vlerëson se shpjegimi i subjektit nuk është i bazuar, pasi në bazë të nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 9049/2003, nëse subjekti do të kishte patur gjendje *cash* në fund të vitit 2016 vetëm shumën 300,000 lekë, ajo duhet të deklaronte edhe mbi gjendjen *cash* të mbetur nga deklarimi i një viti më parë, në DIPP/2015. Për rrjedhojë, ky pretendim është i pabazuar.

**66.5. Si përfundim,** subjekti nuk arriti të provonte të kundërtën e konstatimeve në lidhje me pamundësinë financiare për të krijuar gjendje *cash* në vitin 2011 dhe 2014. Në analizën financiare të vitit 2011 është rivlerësuar zëri “shpenzime jetike”, duke përfshirë në këtë zë edhe shpenzimet për babain e subjektit, bazuar në deklaramet e subjektit se babai ka jetuar me të deri para se të ndërronte jetë, e për pasojë rezultati financiar për këtë vit nga - 3,864,191 lekë shkon në **-4,000,811 lekë**.

Ndërsa rezultati financiar për vitin 2014 mbetet i njëjtë, pra, në shumën **-175,865 lekë**, për sa subjekti nuk arriti të provonte të kundërtën e rezultatit të hetimit.

## Tabela nr. 5

Analiza financiare përfundimtare për vitin 2011 dhe 2014

	2011	2014
<b>PASURI</b>	<b>638 417</b>	<b>181 962</b>
Ndryshim likuiditeti	638 417	181 962
<b>DETYRIME</b>	<b>5 023 807</b>	<b>0</b>
Kredi pranë bankës Raiffeisen disbursuar dt 09.03.2011 per blerje shtëpie.	5 023 807	
<b>PASURI NETO</b>	<b>-4 385 390</b>	<b>181 962</b>
<b>Të ARDHURA</b>	<b>1 306 817</b>	<b>5 855 502</b>
Të ardhura nga paga e SR	1 043 400	1 307 677
Të ardhura nga fitimi bashkëshortit të SR (Person Fizik Stomatolog)	263 417	894 492
Të ardhura nga shitja e shtëpisë 55m2 dhe shtesa 23m2 në Lushnje		3 600 009
Të ardhura nga interesat e Raiffeisen Bank		53 324
<b>SHPENZIME</b>	<b>9 693 018</b>	<b>5 849 405</b>
Shpenzime jetese	683 100	879 992
Shpenzime për pagesë këstesh për blerjen e apartamentit në Tiranë	7 981 575	
Shpenzime për pagesë qiraje në Lushnje		72 000
Shpenzime për pagesë këstesh për SHKK Lushnja 2010		22 224
Shpenzime për arsimin e fëmijëve	28 000	70 000
Shpenzime për pagesën e kredisë shtëpisë në Raiffeisen Bank	557 359	4 284 859
Shpenzime udhëtimi TIMS	342 984	420 330
Shpenzime per mobilim apartamenti ne Tiranë	100 000	100 000
Analiza dokumentuar	<b>-4 000 811</b>	<b>-175 865</b>

**67. Hua** në shumën 10,000 euro, dhënë kunatit (vëllait të bashkëshortit E.Ll.Dh), me qëllim blerjen e një shtëpie banimi prej tij në V, V, Itali ku ai jeton prej vitesh dhe si shtetas italian aktualisht.

**67.1.** Burimi i krijimit të kësaj pasurie: subjekti deklaron se kjo shumë është e kursyer nga të dy bashkëshortët.

#### **Deklarimi i kësaj huaje**

**67.2.** Në DIPP/2015, subjekti ka deklaruar: “...*Të gjitha kursimet cash ndër vite në total prej 10,000 euro ia kemi dhënë hua kunatit ...*”

**67.3.** Në DIPP/2015, personi i lidhur me subjektin ka deklaruar se fondet e deklaruara në gjendje *cash* në shumën 1,300,000 lekë deri në datën 31.12.2014, të cilat i janë dhëna hua vëllait z. E.Dh.

**67.4.** Gjatë deklaramit në ILDKPKI, subjekti ka paraqitur disa akte për të provuar në lidhje me huanë e dhënë: 1) deklaratë<sup>79</sup> e thjeshtë të lëshuar nga shtetasi E.Dh në datën 24.12.2016, në të cilën ka deklaruar se ka marrë hua nga subjekti dhe personi i lidhur shumën prej 10,000 eurosh, të cilën e ka përdorur për blerjen e një apartamenti në datën 6.11.2015 në V në Itali; 2) kontratë shitblerjeje (në gjuhën italiane), e datës 6.11.2015 për një pasuri të paluajtshme me palë blerëse shtetasin E.Dh në çmimin prej 68,000 eurosh; 3) kontratë për kredi bankare (në gjuhën italiane), e datës 6.11.2015 me palë kredimarrëse E.Dh në shumën 54,400 euro për një afat 20-vjeçar; 4) dokumentacion teknik i pasurisë së paluajtshme (në gjuhën italiane).

**67.5.** Nga analiza e fakteve të rezultuara nga hetimi, nuk identifikohet mënyra dhe koha e dhënies së huas prej 10,000 eurosh nga bashkëshorti i subjektit vëllait të tij. Gjithashtu, rezulton se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për të krijuar me burime të ligjshme kursimet *cash*, duke rezultuar me pamundësi financiare në shumën - 3,864,191 lekë në vitin 2011 dhe në shumën - 175,865 lekë në vitin 2014.

**67.6.** Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, si dhe i kërkoi të paraqiste dokumentacionin për blerjen e shtëpisë nga shtetasi E.Dh në formën e kërkuar<sup>80</sup> sipas ligjit.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**68.** Subjekti paraqiti shpjegimet e saj dhe mori kohën e kërkuar për të paraqitur dokumentacion për blerjen e shtëpisë nga kunati i saj z. E.Dh.

**68.1.** Subjekti shpjegoi se huaja është dhënë dorazi kunatit E.Dh dhe vjehrrës N.Dh, të cilët janë në një përbërje familjare gjatë kohës kur kanë ardhur në Shqipëri në vitin 2015, të cilat mund të konfirmohen nëpërmjet lëvizjeve drejt Shqipërisë dhe anasjelltas dhe është kthyer pjesërisht nga kunati nëpërmjet bankës.

**68.2.** Në lidhje me dokumentacionin për blerjen e shtëpisë nga shtetasi E.Dh në Itali, në formën e kërkuar ligjore, subjekti ka sqaruar se për shkak të përhapjes së virusit Covid-19, është ngadalësuar veprimtaria e autoriteteve zyrtare italiane në marrëdhëniet me publikun dhe është

<sup>79</sup> Deklaratë, aneksi \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>80</sup> Bazuar në nenin 266 të K.Pr.C në lidhje me aktet e huaja <sup>80</sup> *Kur shkresa është në gjuhë të huaj, ajo paraqitet bashkë me përkthimin e saj në gjuhë shqipe, të legalizuar nga ambasada apo konsullata përkatëse ose nga organi tjetër kompetent*

zgjatur afati brenda të cilit mund të caktohet një takim me prezencë. Për këtë arsye marrja e kopjes së kontratës pranë zyrës noteriale dhe legalizimi i saj me vulë “Apostille”, ka kërkuar një kohë më të gjatë se afati i zakonshëm, e cila është në procedurë për marrjen e saj.

**68.3.** Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës, vërtetim nga Komuna V, Provinca V datë 30.12.2019, sipas të cilit vërtetohen vendbanimet e shtetasit E.Dh, ku vendbanimi i fundit, sipas regjistrimit të datës 7.11.2016 përkon me adresën e shtëpisë së blerë nga ai në datën 6.11.2015, si dhe dokumentacionin për blerjen e shtëpisë përfshirë dhe aktin kadastral të përkthyer, nëpërmjet të cilit rezultoi se shtetasi E.Dh ka të regjistruar në kadastrë kontratën për blerjen e apartamentit në datën 6.11.2015, si dhe hipotekën për sigurimin e kredisë së marrë për blerjen e shtëpisë. Gjithashtu ka paraqitur disa deklaratat noteriale të lëshuara nga subjekti dhe bashkëshorti i saj për lejimin e udhëtimit në Itali të vajzave të subjektit me gjyshen e tyre, shtetasen N.Dh dhe xhaxhain, shtetasin E.Dh, për të provuar se këta shtetas kanë ardhur në Shqipëri.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**69.** Trupi gjykues, pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti çmon se në tërësinë e fakteve, subjekti nuk ka pasur mundësi për të dhënë huan në shumën prej 10,000 eurosh, për arsye të pamjaftueshmërisë financiare në vitin 2011 në shumën -4,000,811 lekë dhe në vitin 2014 në shumën -175,865 lekë. Subjekti ka pasur detyrimin të depozitujë dokumentacionin e kërkuar sipas ligjit me depozitim të deklaratës “Vetting”, bazuar në pikën 6 të udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive”. Trupi gjykues vlerëson se, edhe nëse do të provohej nga subjekti fakti i blerjes së shtëpisë nga shtetasi E.Dh, përsëri ky fakt nuk do të ndikonte në vendimmarrjen ndaj subjektit të rivlerësimit.

#### **Apartamenti i marrë me qira në Lushnjë, për banim nga subjekti dhe familja e saj nga viti 2014-aktualisht**

**70.** Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar: *Jetojmë familjarisht në një apartament të marrë me qira në vlerën 8,000 lekë në muaj, në lagjen \*\*\*, qyteti I Lushnjës, pranë kishës ortodokse, dhënë nga pronari faktik i tij z. T.Xh.B, sipas deklaratës noteriale nr \*\*\* rep nr \*\*\* kol notere R. K. Apartamenti nuk është regjistruar në ZVRPP.*

**70.1.** Në lidhje me këtë pasuri, Komisioni verifikoi deklarimin e subjektit si dhe kreu hetim, në përfundim të të cilit nuk rezultuan problematika në lidhje me të drejtat reale të subjektit dhe personit të lidhur mbi këtë pasuri.

#### **Pasuritë e deklaruara nga bashkëshorti i subjektit**

**71. Pasuria e llojit “tokë arë”:** a) pasuria me nr. \*\*\*, volum \*\*\*, faqe \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, sipërfaqja 2000 m<sup>2</sup>, fshati P, Lushnjë, vlera 500,000 lekë; dhe b) pasuria me nr. \*\*\*, volum \*\*\*, faqe \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, sipërfaqja 2002 m<sup>2</sup>, fshati P, Lushnjë, vlera 500,000 lekë. Pjesë takuese 100%.

**71.1. Si burim krijimi** të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar të ardhurat e krijuara nga puna në emigracion.

#### **Deklarimi i kësaj pasurie në vite**

**71.2.** Në DIPP/2004, në seksionin e të dhënave konfidenciale, subjekti ka deklaruar: *“tokë arë, në pronësi të bashkëshortit A.D, në dy pjesë: nr.pas. \*\*\*, \*\*\* z.k. \*\*\*.”*

## Hetimi i kryer nga Komisioni për këto pasuri

**71.3.** Nga hetimi i Komisionit, ASHK-ja Lushnjë<sup>81</sup> konfirmon se në emër të personit të lidhur figurojnë të regjistruara dy parcela toke të llojit “arë” me të dhënat e mësipërme.

**71.4.** Nga administrimi i dokumentacionit, ka rezultuar se me kontratën e shitblerjes<sup>82</sup> nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.7.2004, shtetasit Th.Rr, Dh.Rr dhe H.Rr, në cilësinë e bashkëpronarëve, i kanë shitur personit të lidhur A.Dh dy parcela toke me çmimin 50,000 lekë secila, në total prej 100,000 lekë, çmim i paguar plotësisht referuar kësaj kontrate.

**71.5.** Në lidhje me këtë pasuri, gjatë hetimit administrativ<sup>83</sup> rezulton se subjekti ka pretenduar para ILDKPK-së se këto pasuri bashkë me apartamentin i ka blerë bashkëshorti në vitin 1998 me të ardhurat e përfituara nga emigracioni, pretendim i cili nuk u provua pasi kontrata e shitjes së datës 24.8.1998 ka objekt shitjen e apartamentit nga shtetasi Th.Rr kunatit të subjektit, shtetasit E.Dh, pasuri e cila është trajtuar në këtë vendim në seksionin e shtimit të depozitës për vitin 2005.

**71.6.** Në shpjegimet përfundimtare, subjekti i qëndroi të njëjtit pretendim, i cili nuk u pranua nga trupi gjykues, për sa nuk provohej me dokumentacion ligjor.

**71.7.** Nga analiza financiare e vitit 2004, subjekti dhe personi i lidhur me subjektin kanë pasur mundësi të investojnë për blerjen e pasurive “tokë arë”.

**72. Pasuria e llojit “tokë arë” si anëtar i familjes bujqësore, pjesa takuese 20%.**

**72.1. Si burim krijimi** të kësaj pasurie ka deklaruar se është fituar me ligjin “Për tokën”, si anëtar i familjes bujqësore, me AMTP nr \*\*\*, datë 15.11.1993 në emër të nënës së tij, N.Dh. Pjesa takuese 20 %.

## Deklarimi i kësaj pasurie në vite

**72.3.** Në DIPP/2004 subjekti ka deklaruar: *“Tokë arë përfitur nga nga ligji 7501 për tokën bujqësore në pronësi të bashkëshortit A dhe të blera prej tij në bashkëpronësi me anëtarët e familjes së origjinës me kryefamiljare nënën e tij N.Dh”.*

## Hetimi i kryer nga Komisioni për këto pasuri

**72.4.** ASHK-ja Lushnjë<sup>84</sup> nuk konfirmon regjistrimin e kësaj pasurie. Nga administrimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në deklaratën “Vetting” ka rezultuar se me aktin e marrjes së tokës në pronësi<sup>85</sup> të datës 15.11.1993, konfirmohet se në bazë të ligjit nr. 7501, “Për tokën”, datë 19.7.1991, i është dhënë në pronësi znj. N.N.Dh, tokë e llojit “arë”, me sipërfaqe 15,000 m<sup>2</sup> dhe 475 m<sup>2</sup> në përdorim, të ndodhura në fshatin P, Lushnjë.

**72.5.** Pasuria rezulton se është përfitur në emër të nënës të bashkëshortit së subjektit, N.Dh, disa vite para lidhjes së martesës të subjektit me personin e lidhur A.Dh. Për rrjedhojë, Komisioni vlerësoi të mos thellohet në verifikimin e mënyrës së fitimit të kësaj pasurie nga personi i lidhur me subjektin dhe familjarët e tij.

<sup>81</sup> Shkresa kthim përgjigjeje ASHK-ja Lushnjë, nr. \*\*\* prot., datë 8.5.2020.

<sup>82</sup> Kontrata e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.7.2004 në shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 8.5.2020.

<sup>83</sup> Procesverbali i datës 29.4.2015, dosja e ILDKPKI-së.

<sup>84</sup> Shkresa kthim përgjigjeje ASHK-ja Lushnjë, nr. \*\*\* prot., datë 8.5.2020.

<sup>85</sup> Akti i marrjes së tokës në pronësi, aneksi \*\*\*.

## **Çështje të tjera**

**73. Pasuri e llojit “automjet”,** i markës “Mercedes- Benz”, blerë në datë, 25.05.2004, në vlerën prej 2,500 euro, me targa LU\*\*\*B. Shasia \*\*\*

### **Deklarimi i kësaj pasurie në vite**

**73.1.** Në DIPP/2004 subjekti ka deklaruar: “...*Automjet tip Mercedes Benz, blerë nga bashkëshorti A në vitin 2004...*”. Në DIPP 2009 subjekti ka deklaruar:” ... *Të ardhura të përfituara nga shitja e automjetit tip Mercedes Benz me targa LU\*\*\*B, 500,000 lekë në formën e çmimit të shitjes kontratë shitje para noteres R.K dt 21.09.2009 blerës D.M dhe S.B.M...*”.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

**73.2.** Nga hetimi i Komisionit<sup>86</sup> ka rezultuar se me kontratën e shitblerjes me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.6.2004 bashkëshorti i subjektit ka blerë nga vëllai i tij z. E.Dh automjetin tip “Mercedes-Benz” kundrejt çmimit 250,000 lekë të likuiduar para lidhjes së kontratës.

**73.3.** Duke qenë se subjekti nuk ka deklaruar në DIPP/2004 vlerën e blerjes, ILDKPKI-ja i ka kërkuar subjektit sqarime, e cila ka sqaruar<sup>87</sup> se : “...*Automjetin e ka blerë vëllai i bashkëshortit A.Dh në vitin 2004, për llogarinë e bashkëshortit tim, në shumën rreth 2,500 euro, në Itali. Kemi paguar edhe doganën. Në total kemi paguar 315,000 lekë + doganën...*”.

**73.4.** Më tej, ka rezultuar se në datën 21.9.2009, me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., subjekti dhe bashkëshorti i saj e shesin automjetin kundrejt çmimit 500,000 lekë shtetasve D.M dhe S.B (M).

**73.5.** Në shpjegimet përfundimtare, subjekti ka sqaruar se ka harruar të deklarojë në deklaratën e vitit 2004 çmimin e blerjes së automjetit, që e ka saktësuar në ILDKPKI dhe ka depozituar edhe faturën e shitjes në shtetin italian. Në lidhje me burimin e krijimit për blerjen e këtij automjeti, subjekti ka shpjeguar se është paguar pjesërisht nga të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2004 dhe pjesën më të madhe nga kursimet e bashkëshortit nga puna e tij në Itali.

**73.6.** Trupi gjykues, pas shqyrtimit të shpjegimeve të subjektit, çmon se në lidhje me mosdeklarimin e çmimit të blerjes në DIPP/2004, pasaktësia në deklaram nuk është i atij niveli sa të passjellë penalizim për subjektin e rivlerësimit, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, nga analiza financiare e vitit 2004 subjekti dhe personi lidhur me të kanë pasur mundësi të investojnë për blerjen e automjetit “Mercedes- Benz”, blerjen e pasurive “tokë arë”, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera për vitin 2004.

## **74. Njësi shërbimi e marrë me qira për ushtrimin e aktivitetit tregtar dentar si person fizik nga personi i lidhur A.Dh**

**74.1.** Gjatë hetimit administrativ të Komisionit, është pyetur subjekti në lidhje me vendin e ushtrimit të aktiviteti nga bashkëshorti, e cila ka deklaruar<sup>88</sup> se bashkëshorti ka lidhur një kontratë qiraje që pasqyrohet në deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 9.1.2003, në pronësi të shtetasit R.Gj, në shumën 10,000 lekë në muaj.

**74.2.** Për të provuar deklarimin e kryer, subjekti ka paraqitur një deklaratë noteriale<sup>89</sup>, të lëshuar nga shtetasi R.Gj, me anë të së cilës ka deklaruar se është pronar i një pasurie të llojit “njësi”, me sipërfaqe 27,9 m<sup>2</sup>, e ndodhur në lagjen “S. L”, Lushnjë, me numër pasurie \*\*\*-ndërtesa

<sup>86</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 4.8.2021 dhe kthim përgjigjeje nr.\*\*\* prot., datë 16.8.2021, e DPSHTRR-së.

<sup>87</sup> Shih procesverbalin e datë 29.4.2015 dërguar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.6.2021

<sup>88</sup> Shih përgjigjen e pyetjes 9.1 të pyetësorit 2.

<sup>89</sup> Deklarata nr. \*\*\* rep., nr \*\*\* kol., datë 9.1.2013, lëshuar nga R.Gj.

\*\*\*, volum \*\*\*, faqe 150, zona kadastrale \*\*\*, të cilin ia ka dhënë me qira bashkëshortit të subjektit për një periudhë 5-vjeçare, duke filluar nga data 9.1.2013 në shumën 10,000 lekë/muaj. Gjithashtu, në shpjegimet përfundimtare, subjekti paraqiti në cilësinë e provës vërtetimin hipotekor datë 19.6.2006 për këtë pasuri në pronësi të zotit R.Gj. Trupi gjykues, nuk konstatoi problematika në lidhje me këtë pasuri.

**75. Hua e marrë në shoqërinë e kursim kreditit “A.C”.** Nga hetimi i Komisionit<sup>90</sup>, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë marrë hua në shumën 350,000 lekë pranë shoqërisë së kursim- kreditit “L 2010”, sot “Alb Credit”, me kontratën e datës 4.7.2013 me objekt “blerje pajisje grafie dentare”, për sigurimin e të cilës ka vendosur peng pajisjet e klinikës dentare. Huaja është shlyer para afatit në datën 13.1.2014.

**75.1.** Në lidhje me këtë pasuri, pasi iu kërkuan shpjegime subjektit për mosdeklarimin e kësaj huaje, trupi gjykues i konsideroi bindëse ato dhe nuk konstatoi problematika të mëtejshme.

### **Analiza financiare për vitet 2003 – 2016**

**76.** Nga analiza financiare e kryer për periudhën 2003-2016, subjekti ka rezultuar me pamjaftueshmëri financiare për të mbuluar me burime të ligjshme krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera për vitin 2005 në shumën -1,883,313 lekë, për vitin 2011 në shumën - 3,864,191 lekë, për vitin 2012 në shumën - 1,251,943 lekë dhe për vitin 2014 në shumën- 175, 865 lekë. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës, për të provuar të kundërtën e rezultatit, për të paraqitur shpjegime, si dhe për të paraqitur prova për mbulimin e shpenzimeve të qëndrimit për udhëtimet në Itali.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**77.** Subjekti ka pretenduar që analiza financiare të ndryshohet dhe pasaktësitë e konstatuara nga Komisioni të mos bëhen shkak për penalizimin e saj. Ajo ka pretenduar se në analizën financiare duhet të përfshihen të ardhurat e bashkëshortit përpara martesë rreth 30,000 euro të administruara në vitet përkatëse, ku pjesa më e madhe prej tyre janë dhënë kunetërve në përdorim dhe pjesa tjetër është shpenzuar për blerjen e automjetit në vitin 2004, fitimi kapital nga shitja e apartamentit në vitin 2005, si dhe të ndryshojë gjendja *cash* në fund të vitit 2009, ku të bëhet 1,000,000 lekë, të ndryshojë gjendja e likuditetit në fund të vitit 2010, pasi, sipas subjektit, ajo ka pasur të drejtën e depozitës për pjesën e lënë në dispozicion familjes Q.

**77.1.** Për vitin 2011 të ndryshojë gjendja e likuditetit që vjen si rezultat i likuditetit në fund të vitit 2010 dhe të njihen të ardhurat nga kursi i këmbimit në këtë vit, pasi pjesa e mbetur e depozitës është konvertuar në euro në vitin 2011, si dhe gjendja *cash* në fund të vitit 2011 të bëhet 1,000,000 lekë, që përfshin shtimin në shumën 500,000 lekë në 2011 dhe gjendja 500,000 lekë nga viti 2010. Për vitin 2012 dhe 2013 të përfshihen në analizë të ardhurat e lëna nga trashëgimia e babait të saj. Për vitin 2014 duhet të hiqen shpenzimet e mobilimit, pasi, sipas subjektit, për vitin 2013 ka paraqitur 200,000 lekë shpenzime mobilimi. Pra, sipas subjektit nëse reflektohen këto ndryshime, analiza financiare do të rezultonte me balancë pozitive. Subjekti paraqiti në cilësinë e provave akt provues “deklaratë mikpritjeje” datë 2.7.2021 dhënë nga shtetasit A dhe E.Dh, për të provuar se nuk ka pasur shpenzime gjatë qëndrimit në Itali.

<sup>90</sup> Shkresë me nr. \*\*\* prot., datë 29.7.2021 dhe kthim përgjigje me nr. \*\*\* prot., datë 10.8.2021, shoqëria “A.C”.

## **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**78.** Trupi gjykues, pasi shqyrtoi shpjegimet dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, vlerëson se pretendimet e subjektit në lidhje me analizën financiare janë shqyrtuar dhe trajtuar në këtë vendim, në kuptim të barrës së provës së lënë për të provuar mundësitë financiare të subjektit dhe personit të lidhur me të për krijimin e pasurive objekt vlerësimi, për të cilat subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën.

**78.1.** Në lidhje me pretendimin e subjektit për mospërfshirjen në vitin 2014 të zërit “shpenzime mobilimi” për apartamentin në Tiranë për arsye se këto shpenzime janë kryer në vitin 2013, trupi gjykues çmon se subjekti është pyetur në mënyrë të përsëritur<sup>91</sup> gjatë hetimit administrativ në lidhje me shpenzimet e mobilimit, ku i është kërkuar të përcaktojë ndër vite shpenzimet e kryera për efekt të analizës financiare vjetore. Në vijim, subjekti ka deklaruar se shpenzimet për mobilimin e shtëpisë janë kryer ndër vite në vlera modeste që nuk i kalojnë shumën 300,000-400,000 lekë në total, duke filluar që nga viti 2011 dhe se nuk disponon fatura. Mbi bazën e deklarimit të subjektit, trupi gjykues ka vlerësuar ndarjen e totalit të shpenzimeve të mobilimit prej 400,000 lekë në mënyrë të barabartë për katër vite, duke filluar nga viti 2011. Për rrjedhojë, në analizën financiare përfundimtare zëri “shpenzime mobilimi apartamenti në Tiranë” nuk ka ndryshuar.

**78.2.** Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga trashëgimia e babait të subjektit në vitin 2013 likuiditete bankare në shumën rreth 619,265 lekë, këto të ardhura janë konsideruar në analizën financiare përfundimtare. Trupi gjykues i vlerësoi bindëse shpjegimet e subjektit se, duke qenë fëmijë i vetëm, ka pasur nën përgjegjësinë e saj financiare babain dhe se shpenzimet për të janë mbuluar nga subjekti i rivlerësimit. Për rrjedhojë, është e besueshme që gjendja *cash* e akumuluar nga babai i subjektit në shumën rreth 900,000 lekë dhe në likuiditete bankare, të jetë disponuar nga subjekti i rivlerësimit dhe familja e saj pas vdekjes së babait të saj dhe lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë.

**78.3.** Përfundimisht, për sa u analizua më lart, trupi gjykues konkludon se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së proves, duke rezultuar me pamjaftueshmëri financiare ndër vite si vijon : për vitin 2005 – balanca negative e fondeve (- 1,392,870 lekë); për vitin 2011 – balanca negative e fondeve (- 4,000,811 lekë); për vitin 2012 – balanca negative e fondeve (- 351,943 lekë); për vitin 2014 – balanca negative e fondeve (- **175, 865 lekë**).

**78.4.** Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të evidentuara për vitet 2005, 2011, 2012, 2014, në total me një balancë negative prej **-5,921,489 lekë**.

### **Konkluzione për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe vlerësimi tërësor i çështjes**

**79.** Mbështetur në rrethanat e faktit, si dhe provat shkresore të administruara në dosjen e hetimit, lidhur me kriterin e vlerësimit pasuror, trupi gjykues konkludon se:

**79.1. Lidhur me investimin në depozita në vitin 2005,** subjekti ka kryer deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me burimet e krijimit të depozitave, duke rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme për të justifikuar krijimin e tyre në shumën prej **-1,392,870 lekësh**, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

**79.2. Lidhur me pasurinë “apartament” me sipërfaqe 112,1 m<sup>2</sup>** e ndodhur në S, Tiranë; i) për pagesën e këstit të parë prej 25,000 eurosh në datën 17.12.2010, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në DIPP/2010 për pagesën e këtij kësti me burim nga depozita bankare në

<sup>91</sup> Pyetësori 1, pyetja 14 dhe pyetësori 2, pyetja 11.

“Raiffeisen Bank”, pasi nga hetimi rezultoi se subjekti nuk ka përdorur depozitën si burim për pagesën e kështit të parë. Gjithashtu, subjekti ka rezultuar me mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën prej **-4,225,563 lekë** për të justifikuar pagesën e kështit të parë, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016; ii) për pagesën e kështit të dytë në shumën prej 20,000 euro në datën 11.2.2011, subjekti gjithashtu ka kryer deklaram të pasaktë në DIPP/2011 në lidhje me burimin depozitë bankare në “Raiffeisen Bank” për blerjen e apartamentit, pasi nga hetimi rezultoi se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën e një viti më parë gjendje të kësaj depozite, të tërhequr në vitin 2010, që të mund të përbënte burim krijimi për pagesën e kështit të dytë në datën 11.2.2011. Gjithashtu, subjekti ka rezultuar me mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën prej **-2,783,173 lekë** për të justifikuar pagesën e kështit të dytë, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

**79.3. Lidhur me pasurinë “autoveturë”, marka “Mercedes- Benz”, tipi “ML \*\*\*”,** blerë në datën 5.7.2010, subjekti nuk ka kryer deklarimin e kësaj pasurie në DIPP/2010, në përputhje me ligjin nr. 9049/2003, si dhe ka rezultuar me mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën prej **-1 233 279 lekë** për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie në datën 5.7.2010, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b” të ligjit nr. 84/2016.

**79.4. Referuar analizës financiare për vitet 2003-2016,** subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të konstatuara për vitin 2005 në shumën **-1,392,870 lekë**, për vitin 2011 në shumën **-4,000,811 lekë**, për vitin 2012 në shumën **-351,943 lekë** dhe për vitin 2014 në shumën **-175,865 lekë**, me total pamjaftueshmërie prej **-5,921,489 lekë**, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” të ligjit nr. 84/2016.

**79.5.** Komisioni, bazuar në konkluzionet e mësipërme, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurive të tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

## KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe në përfundim të tij, konkludon se subjekti nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

### PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 2 të nenit 4, si edhe pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “c”, si dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Saemira Hila, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik, vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.



3. Ky vendim mund të ankimohehet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 5.11.2021.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Brunilda Bekteshi**

**Kryesuese**

**Roland Ilia**

**Anëtar**

**Pamela Qirko**

**Relatore**

*Sekretare gjyqësore*

***Amela Idrizi***

## ANEKS 1 - ANALIZA FINANCIARE PËRMBLEDHËSE

	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<b>PASURI</b>	<b>0</b>	<b>2,676,847</b>	<b>3,237,203</b>	<b>1,706,654</b>	<b>359,547</b>	<b>502,217</b>	<b>75,504</b>	<b>5,635,921</b>	<b>638,417</b>	<b>1,125,166</b>	<b>-363,894</b>	<b>181,962</b>	<b>-646,154</b>	<b>417,572</b>
Apartament në bashkëpronësi me bashkëshortin, me sipërfaqe totale 112.1 m <sup>2</sup> , me nr.pas. ***, ZK ***, S, Tiranë, blerë në 15.2.2011 me kontratë noteriale para								11,451,825						
Automjet Mercedes Benz ML me targa AA***DB (***), në bashkëpronësi me bashkëshortin. Vlera e autoveturës 9.000 euro								1,249,290		194,507				
Automjet Mercedes Benz *** vitprodhimi 1992 me targa LU***B. Shasia nr *** Vlera e autoveturës 500,000 lekë		510,000												
Apartamentin me sip.55 m2, dhe shtesë anësore me sip.23 m2 Rr.***														
Pasuri e paluajtshme e llojit "arë", nr.***, Vol.***, fq.***, ZK ***, sip.2000 m2, dhe pasuria e paluajtshme e llojit "arë", nr.***, Vol.***, fq.***, ZK ***, sip.2002 m2 fshati P Lushnje.		100,000												
Arë me sip.15,000 m2, P, Lushnjë, përfituar nga familja e b/shortit nga ligji 7501.. Zotëron 20 % b/shorti.														
Apartament me sipërfaqe 73 m2 ne fshatin P datë 24.08.1998														
Ndryshim likuiditeti	0	2,066,847	3,237,203	1,706,654	359,547	502,217	75,504	-7,065,194	638,417	930,659	-363,894	181,962	-646,154	417,572
<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>7,981,575</b>	<b>5,023,807</b>	<b>0</b>	<b>350,000</b>	<b>0</b>	<b>112,000</b>	<b>0</b>
Kredi pranë bankës Raiffeisen disbursuar dt 09.03.2011 per blerje shtëpie.									5,023,807					
Kredi pranë SHKK ALB CREDIT disbursuar dt 15.07.2013.											350,000			
Kredi pranë Credins Bank disbursuar dt 25.06.2015													112,000	
Detyrim I mbetur ndaj shoqërisë së ndërtimit për blerje shtëpie.								7,981,575						
<b>PASURI NETO</b>	<b>0</b>	<b>2,676,847</b>	<b>3,237,203</b>	<b>1,706,654</b>	<b>359,547</b>	<b>502,217</b>	<b>75,504</b>	<b>-2,345,654</b>	<b>-4,385,390</b>	<b>1,125,166</b>	<b>-713,894</b>	<b>181,962</b>	<b>-758,154</b>	<b>417,572</b>
<b>TË ARDHURA</b>	<b>613,649</b>	<b>3,977,178</b>	<b>2,470,790</b>	<b>2,677,439</b>	<b>1,474,577</b>	<b>1,580,753</b>	<b>2,552,761</b>	<b>1,457,206</b>	<b>1,306,817</b>	<b>2,469,008</b>	<b>1,738,797</b>	<b>5,855,502</b>	<b>3,580,036</b>	<b>3,758,444</b>
Të ardhura nga paga e SR	613,649	626,743	779,111	895,345	248,501	674,566	896,875	959,114	1,043,400	948,517	1,011,464	1,307,677	1,459,895	1,406,831
Të ardhura nga bashkëshorti para martesë		1,659,435												
Të ardhura nga fitimi bashkëshortit të SR (Person Fizik Stomatolog)		625,000	1,000,476	1,400,000	550,000	691,740	950,000	239,446	263,417	583,609	676,741	894,492	2,098,801	2,338,035
Të ardhura nga trashëgimia e prindërve të SR (banka Raiffeisen)		1,066,000								900,000				
Të ardhura nga shitja e automjetit Benz 250 me targa LU***B							500,000							
Të ardhura nga shitja e shtëpisë 55m2 dhe shtesa 23m2 në Lushnje												3,600,009		
Të ardhura nga bashkëshorti (depozituar në Tirana Bank)			600,000											
Të ardhura nga interesat e Raiffeisen Bank			11,078	237,337	79,294	104,597	205,886	62,928		36,882	50,592	53,324	21,340	13,578
Të ardhura nga këmbimi valutor nga lekë në usd								195,718						
Të ardhura nga interesat e bono thesari			80,125	144,757	222,728	109,850								
Të ardhura ISSH (leje lindje SR)					374,054									
<b>SHPENZIME</b>	<b>93,864</b>	<b>321,268</b>	<b>626,457</b>	<b>690,383</b>	<b>1,045,154</b>	<b>906,283</b>	<b>1,066,490</b>	<b>932,958</b>	<b>9,693,018</b>	<b>1,695,785</b>	<b>2,069,895</b>	<b>5,849,405</b>	<b>3,629,704</b>	<b>2,039,256</b>
Shpenzime jetese	93,864	308,594	438,228	438,228	653,156	683,100	683,100	683,100	683,100	564,096	564,096	879,992	897,104	940,368
Shpenzime për pagesë këstesh për blerjen e apartamentit në Tiranë									7,981,575					
Shpenzime për pagesë qiraje në Lushnje												72,000	96,000	96,000
Shpenzime për pagesë këstesh për SHKK ALB CREDIT											341,000	22,224		
Shpenzime për pagesë këstesh për CREDINS Bank													61,844	55,998
Shpenzime për arsimin e fëmijëve									28,000	70,000	70,000	70,000	42,000	
Shpenzime për pagesën e kreditesë shtëpisë në Raiffeisen Bank									557,359	585,413	605,939	4,284,859	499,502	
Shpenzime për dhënie hua ndaj vëllait të personit të lidhur													1,376,500	
Shpenzime udhëtimi TIMS		12,674	88,229	152,155	291,998	123,183	383,390	249,858	342,984	376,276	388,860	420,330	550,600	946,890
Shpenzime per mobilim apartamenti ne Lushnje			100,000	100,000	100,000	100,000							106,154	
Shpenzime per mobilim apartamenti ne Tiranë									100,000	100,000	100,000	100,000		
Analiza dokumentuar	519,785	979,063	-1,392,870	280,402	69,876	172,254	1,410,767	2,869,902	-4,000,811	-351,943	382,796	-175,865	708,486	1,301,616